

Barazia gjinore

Kusht për integrimin europian

Botimi i parë shkurt 2008
Botimi i dytë dhjetor 2008



Botim i Qendrës
“Aleanca Gjinore për Zhvillim”



Ky publikim u mundësua falë mbështetjes së AECI (Agjencia Spanjolle për Bashkëpunimin Ndërkombëtar). Opinionet dhe sugjerimet e paraqitura në këtë studim i përkasin autoreve dhe nuk përfaqësojnë domosdoshmërisht këndvështrimet e AECI-së apo të çdo organizate tjetër ku AECI është anëtare.

Ky është libri i dytë i kolanës “Barazia gjinore dhe integrimi europian”

Autore, botimi i dytë: Blerta Picari

Autoret, botimi i parë: Valdet Sala dhe Blerta Picari

Adresa: Qendra “Aleanca Gjinore për Zhvillim”

Kutia postare 2418, Tiranë

Tel. & Fax: (355) 4 255514/5

E-mail: info@gadc-al.org

Këtë botim mund ta gjeni në

formë elektronike në adresën: www.gadc-al.org

Layout: Llazar Jorganxhi

© 2008 Botim i Dytë; © 2005 Botim i Parë - Të gjitha të drejtat janë të rezervuara për Qendrën “Aleanca Gjinore për Zhvillim”, Tiranë, Shqipëri.

Tabela e Përmbajtjes

<i>Shkurtime</i>	5
<i>Hyrje</i>	6
<i>1. Bashkimi European dhe institucionet kryesore të tij</i>	9
<i>2. Legjislacioni i Bashkimit European lidhur me barazinë gjinore</i>	14
2.1 Legjislacioni i BE-së për Barazinë Gjinore	16
2.2 Integrimi gjinor	20
2.3 Mbështetja Financiare	26
2.4 Mekanizma dhe institucione për barazinë gjinore të përdorura nga BE	29
<i>3. Integrimi në BE – një proces i komplikuar.</i>	31
3.1 Përse nuk mund të arrihet integrimi në BE jashtë kornizës së barazisë gjinore dhe asaj të mundësive të barabarta?	32
<i>4. Kuadri ligjor dhe mekanizmat kombëtare shqiptare mbi barazinë gjinore</i>	38
4.1 Mungesa e institucioneve mbështetëse	41
4.2 Pakti i Stabilitetit dhe Marrëveshja e Stabilizim Asociimit – një mekanizëm rajonal	44

4.3 Kalendar i hapave të Shqipërisë drejt Marrëveshjes së Stabilizim Asociimit:	46
4.4 Përparësitë e MSA-së lidhur me Barazinë Gjinore	48
4.5 Objektiva, synime dhe mekanizma	49
4.6 Arritja e Objektivave të Zhvillimit të Mijëvjeçarit në bashkëpunim me Konventën CEDAW dhe PVP	52
4.7 Pjesët përbërëse të Programit për Mundësi të Barabarta të OZHM-së	53
4.8 Nxitja e barazisë gjinore dhe fuqizimi i rolit të gruas	58
4.9 Fuqizimi i grave në Shqipëri	60
4.10 Debati mbi kuotat	62
4.11 Zvogëlimi i vdekshmërisë foshnjore dhe përmirësimi i shëndetit të nënës	67
4.12 Shëndeti i nënave dhe fëmijëve në Shqipëri	67
4.13 Lufta ndaj HIV/SIDA, malaries dhe sëmundjeve të tjera	69
4.14 Përmirësimi i mjedisit përreth	69
4.15 Zhvillimi i një plani botëror bashkëpunësues	70
<i>5. Përfundime</i>	71
5.1 Aty ku ka Vullnet, ka dhe rrugëzgjdhje	71
<i>Fjalorth termash</i>	73
<i>Dokumente ndërkombëtare të nënshkruara nga Qeveria Shqiptare</i>	81
<i>Bibliografia</i>	84
<i>Burime nga Interneti:</i>	88

Shkurtime

BE	Bashkimi European
CEDAW	Konventa për Eliminimin e të Gjitha Formave të Diskriminimit ndaj Gruas
INSTAT	Instituti i Statistikës
KBE	Këshilli i Bashkimit European
KE	Komisioni European
GJEA	Gjykata Europiane e Auditimit
GJED	Gjykata Europiane e Drejtësisë
OZHM	Objektivat e Zhvillimit të Mijëvjeçarit
PVP	Platforma për Veprim e Pekinit
PNUD	Programi i Zhvillimit të Kombeve të Bashkuara
PE	Parlamenti European
PS	Pakti i Stabilitetit
MSA	Marrëveshja e Stabilizim Asociimit

Hyrje

Kjo broshurë është përgatitur dhe botohet në kuadrin e projektit “Fuqizimi i një kuptimi më të mirë nga ana e shoqërisë shqiptare në lidhje me mundësitë e barabarta midis gjinive në kuadër të Integritimit Europian”, i mbështetur nga Agencia Espanola de Cooperacion Internacional (AECI)

Botimi i kësaj broshure është një iniciativë e Qendrës së Aleancës Gjinore për Zhvillim, në kuadër të integritimit të perspektivës gjinore dhe përmirësimit të ekuilibrit gjinor në vendimmarrje. Në këtë broshurë, vëmendje e veçantë i është kushtuar jo vetëm prezantimit të Bashkimit Europian si institucion dhe koncept, por edhe organeve kryesore të tij, nëpërmjet paraqitjes së funksioneve dhe përgjegjësisë të secilit. Gjithashtu në këtë broshurë paraqiten hapat e vështira që Shqipëria duhet të kalojë për të përmbushur kushtet e paraqitura nga BE në lidhje me barazinë gjinore.

Në median shqiptare, shpesh prezantohet integrimi i Shqipërisë në BE si diçka që do të ndodhë shumë shpejt dhe sapo të ndodhë, cilësia e jetës së Shqiptarëve do të përmirësohet ndjeshëm. Zakonisht shqyrtimi i plotë i angazhimeve

qeveritare dhe pritshmëritë që BE parashtron ndaj çdo vendi kandidat lihen mënjanë, duke lënë të kuptohet se është më shumë dëshira e BE-së sesa kushtet e paracaktuara ato që mundësojnë pranimin e një vendi në Komunitetin European. Gjithashtu, reformat dhe zhvillimet reale të vendit shpesh ose anashkalohen ose mbivlerësohen në krahasim me kriteret e paraqitura. Ky libërth synon të përmbledhë shkurtimisht jo vetëm legjislacionin dhe mekanizmat zbatues që vetë BE zbaton për të arritur barazinë gjinore, por dhe të korrigjojë perceptimin e gabuar që ekziston në Shqipëri duke synuar të qartësojë idetë, angazhimet dhe pritshmëritë që duhet të përmbushen gjatë fazës së parapërgatitjes së Shqipërisë për t'u anëtarësuar në BE, gjithmonë duke u përqendruar në çështjen e barazisë gjinore.

Anëtarësimi në BE kërkon përmbushjen e kërkesave paraprake dhe zbatimin e reformave ekonomiko-ligjore, duke nënvizuar rëndësinë e përfshirjes së grave dhe vajzave. Në këtë mënyrë, synohet të analizohen përparësitë dhe boshllëqet që ekzistojnë në kuadrin ligjor shqiptar, duke reflektuar mbi legjislaturën, mekanizmat dhe strategjitë e BE-së. Pra, pyetja lind vetvetiu: Cilat janë standardet që Shqipëria duhet të arrijë për t'u anëtarësuar në BE dhe cilat janë arritjet e vendit tonë për sa i përket **legjislaturës** dhe **mekanizmave** të fuqizimit të gruas për të pasur një shoqëri ku gratë dhe burrat kanë të drejta të barabarta?

Kjo broshurë synon t'u japë përgjigje pyetjeve të mësipërme, duke pasur parasysh se kjo është vetëm një pikë në oqeanin e madh të hapave që duhen hedhur drejt integrimit në Bashkimin Europian.

1. Bashkimi European dhe institucionet kryesore të tij

Bashkimi European (BE) – (European Union) (EU): është familja e vendeve demokratike Europiane të përkushtuara të punojnë së bashku për paqe dhe prosperitet. BE nuk është një shtet që synon të zëvendësojë shtetet ekzistuese, por është më shumë se çdo organizatë ndërkombëtare, pra diçka e veçantë. Shtetet anëtare të BE-së kanë krijuar institucione të përbashkëta tek të cilat delegojnë pjesë të sovranitetit të tyre me qëllim që vendimet për çështje specifike të interesit të përbashkët të mund të merren në mënyrë demokratike në nivel European. Përmbajtja e këtij sovraniteti të deleguar bashkërisht nga shtetet anëtare, shpesh quhet edhe Integrim European.

Rrënjët historike të BE-së i kanë fillesat që në Luftën e Dytë Botërore ku u konceptua një Europë e Bashkuar, në të cilën të integroheshin përgjegjësitë historike e politike dhe të institucionalizoheshin bashkërisht për të parandaluar tragjedi të ngjashme me atë të Luftës së Dytë Botërore. Ky bashkim ka lindur fillimisht në fushën ekonomike duke shërbyer si një institucion integrimi dhe më pas është përqendruar dhe në fushën politike dhe sociale.

Qeverisja e ligjit është themelore në BE. Të gjitha vendimet dhe procedurat e BE-së bazohen në traktatet e miratuara nga të gjitha vendet anëtare.

Paketa ligjore që qeveris BE-në është quajtur “acquis communautaire” dhe është e detyrueshme të adoptohet nga çdo vend para se të mund të bëhet shtet anëtar i BE-së. “Acquis communautaire” mund të ndahet në legjislacionin parësor/primar; Traktatet që kanë krijuar dhe stabilizuar Komunitetin European dhe legjislacionin dytësor/sekondar, që janë në fakt direktivat të cilat rrjedhin ose janë zhvilluar në përputhje me Traktatet e BE.

Më poshtë renditen katër traktatet që kanë themeluar BE:

- Traktati që ka krijuar Komunitetin European të Qymyrit dhe Çelikut (European Coal and Steel Community/ECSC);
- Traktati që themeloi Komunitetin Ekonomik European (European Economic Community/EEC);
- Traktati i Komunitetit European të Energjisë Atomike (European Atomic Energy Community/Euratom);
- Traktati i Bashkimit European, ai që ndryshoi emrin nga Komuniteti Ekonomik European në thjesht Komuniteti European. Kryesisht njihet si traktati i Maastrichtit.

Komisioni European (KE) – (European Commission) (EC): është një trup i pavarur që funksionon në nivelin ekzekutiv të BE-së. Kur flasim për çështjen e barazisë gjinore, ky trup

përfaqëson atë çka nevojitet për eliminimin e diskriminimit me origjinë përkatësinë gjinore, duke qenë në gjendje të merret me procedura ligjore që kanë të bëjnë me moszbatimin e të drejtave të barabarta të dy gjinive. Në bashkëpunim me Gjykatën Europiane të Drejtësisë, e cila ka si funksion balancimin e fuqive të institucioneve të vendeve të ndryshme me atë të BE-së, vihet re se KE ka pasur dhe funksion legjislativ ku mund të përmenden ligjet e ndryshme mbi mundësitë e barabarta midis dy gjinive. Ndër këto ligje ia vlen të përmendet Direktiva e Mundësive të Barabarta për Punësim, Aksesit ndaj të Mirave dhe Shërbimeve, Sigurim Shëndetësor dhe Pension; Mbrojtja e Grave Shtatzënë dhe Ushqyeset me Gji; si dhe i Lejes së Lindjes për të dy Prindërit. Strategjia Europiane e Punësimit gjithashtu, është një element themelor i ligjit të BE-së, duke pasur objektiva të tilla si: ajo e punësimit të plotë, cilësinë e lartë të punës dhe produktivitetin, si dhe mirëqenien shoqërore. Kjo strategji ecën nën filozofinë se një treg pune që funksionon mirë duhet të përfshijë të dy gjinitë, zvogëlojë papunësinë me afat të gjatë, gjë që është më karakteristike për gratë, dhe ngushtojë hendekun që ekziston në diferencën e pagesës së punës mes dy gjinive.¹

Parlamenti Europian (PE) – (The European Parliament) (EP): zgjidhet nga qytetarët e BE-së në përfaqësim të interesave të tyre. Fillesat e tij datojnë në vitin 1950, dhe që vitin 1979

¹ Gender and European Integration, Glas Razlike. Për informacion të mëtejshëm drejtohuni tek www.womenngo.org.yu/gazrazlike (Parë për herë të fundit: 10 nëntor 2005).

anëtarët e tij zgjidhen çdo 5 vjet, ku çdo qytetar me të drejtë vote, i vendit anëtar në BE, ka të drejtë të votojë për anëtarët e Parlamentit Europian. Në këtë mënyrë, PE shpreh vullnetin demokratik të qytetarëve të Bashkimit Europian (më shumë se 492 milionë njerëz). Parlamenti aktual Europian ka 785 deputetë nga të 27 vendet anëtare.²

Këshilli i Bashkimit Europian (KBE ose KiE)– (The Council of the EU) (CEU): është institucioni kryesor vendimmarrës i BE-së. Ashtu sikurse dhe PE, ky Këshill u themelua përmes traktateve të themelimit në vitin 1950. Ai përfaqëson shtetet anëtare dhe në mbledhjet e tij marrin pjesë një ministër/re nga qeveria e secilit shtet anëtar.³

Gjykata Europiane e Drejtësisë (GJED) – (The Court of Justice) (CJ): është ngritur bazuar në traktatin ECSC në vitin 1952⁴ dhe është e vendosur në Luksemburg. Detyra e kësaj gjykate është të sigurojë që legjislacioni i BE-së të interpretohet dhe aplikohet në të njëjtën mënyrë në të gjitha vendet e BE-së. Në këtë mënyrë, ky legjislacion do të jetë i njëjtë për të gjithë shtetasit e vendeve anëtare. Gjykata

2 Parlamenti Europian. Për më shumë informacion, vizitoni <http://www.europarl.europa.eu/parliament/public.do?language=en> (Parë për herë të fundit: 10 shkurt 2008).

3 Po aty.

4 Traktati që ka ngritur Komunitetin e Qymyrit dhe Çelikut (ECSC) u nënshkrua në Paris, më 18 Prill 1951 nga Belgjika, Gjermania, Franca, Italia, Luksemburgu dhe Holanda. Në takimin përkatës u arrit në konkluzionin se kohëzgjatja ligjore duhet të përfundonte më 23 Korrik 2002 http://curia.europa.eu/en/instit/presentationfr/index_cje.htm (parë për herë të fundit më 10 shkurt 2008).

zotëron pushtetin të vendosë debati të ligjshme midis shteteve anëtare, institucioneve të BE-së si dhe bizneseve e individëve.⁵

Gjykata Europiane e Auditimit (GJEA)– (The European Court of Auditors) (ECA): Gjykata Europiane e Auditimit u ngrit në vitin 1975 dhe ndodhet në Luksemburg. Roli i Gjykatës është të kontrollojë fondet e BE-së, të cilat vijnë nga taksapaguesit, mblidhen në mënyrën e duhur dhe paguhen në mënyrë të ligjshme dhe të arrijë qëllimet e synuara. Gjykata ka anëtarë nga çdo vend i BE-së, të cilët caktohen nga KE më të drejtë rizgjedhjeje çdo 6 vjet. Anëtarët zgjedhin Presidentin për një periudhë 3 vjeçare me të drejtë rizgjedhjeje.⁶

5 Po aty.

6 Po aty.

2. Legjislacioni i Bashkimit European lidhur me barazinë gjinore

Përmbledhje e legjislacionit, politikave dhe institucioneve për barazinë gjinore të BE-së

BE ka krijuar një legjislacion të rëndësishëm në fushën e barazisë gjinore: 40 vjet pas marrëveshjes së Romës, Samiti i Esenit (dhjetor 1994), u përqendrua në identifikimin e mundësive të barabarta për gratë dhe burrat si një “detyrë parësore” e BE-së, të cilat janë konsideruar si kusht për zhvillimin ekonomik të tregut të brendshëm.⁷ Si rrjedhojë, në ditët e sotme, promovimi i mundësive të barabarta gjinore është një element qendror në politikat dhe planifikimin ekonomik të BE-së dhe shteteve anëtare në veçanti. Traktati i të Drejtave Themelore të Bashkimit European garanton si një parim themelor barazinë midis burrave dhe grave.

7 Interim report of the Commission to the European Parliament, the Council, the Economic and Social Committee and the Committee of the Regions on the implementation of the medium-term *Community Action Programme on equal opportunities for women and men* (1996 to 2000) – European Commission, Directorate-General for Employment, Industrial Relations and Social Affairs, 1999.

Megjithatë, edhe më parë se viti 1994, kur BE kishte shpallur përkushtimin politik në fushën e mundësive të barabarta për gratë dhe burrat, barazia gjinore ishte një shqetësim i konsiderueshëm për Komunitetin Europian. E para Direktivë mbi mundësitë e barabarta për gratë dhe burrat është ajo e shkurtit 1975 (D. 75/117/EEC) e bazuar mbi parimin e pagës së barabartë. Ky parim e përcakton pagën e barabartë jo vetëm për punë të barabartë, por edhe për punë me vlerë të barabartë. Ky parim u trupëzua më vonë në Traktatin e Maastrihit (Neni 119) dhe u zhvillua më tej në Traktatin e Amsterdimit (1 maj, 1999, Neni 141). Barazia gjinore në tregun e punës u bë një linjë europiane parësore. Për këtë arsye, më 1998, u miratuan Orientimet e Punësimit, mbështetur në vendimet e Këshillit të Europës të dhjetorit 1997.⁸

Përkushtimi i BE-së për mundësi të barabarta për gratë dhe burrat u legalizua me hyrjen në fuqi të Traktatit të Amsterdimit. Ky traktat formalizon dhe legjitimon në nivel europian procesin e barazisë gjinore, atë të perspektivës gjinore si dhe të mundësive të barabarta për gratë dhe burrat. Në traktat artikulohe qartë si detyra dhe objektiva të BE-së: eliminimi i pabarazisë (Neni 2) dhe promovimi i mundësive të barabarta midis grave dhe burrave (Neni 3.2). Për më tepër, Traktati i Amsterdimit, (në Nenin 13) përcakton që KBE “të ndër marrë veprimet e duhura për të luftuar diskriminimin që bazohet në diferencat gjinore”.

8 Council Resolution of 15 December 1997 on the 1998 Employment Guidelines (98/C 30/01), OJ No. C 030, 28.1.98, p.1.

BE zbaton tre mënyra kryesore për arritjen e barazisë gjinore:

- Legjislacionin e BE-së, si atë parësor ashtu edhe atë dytësor (tek i fundit futen rregulloret, direktivat, vendimet dhe rekomandimet).
- Integrimin gjinor
- Mbështetjen financiare

2.1 Legjislacioni i BE-së për Barazinë Gjinore

Legjislacioni i BE-së në fushën e mundësive të barabarta është rrjedhojë e Traktatit të Amsterdamit dhe përmbledh të gjitha Direktivat e BE-së që kanë dalë në mbështetje të Traktatit.

Marrëveshja e Themelimit (1957) ka disa nene që lidhen drejtpërdrejt me barazinë gjinore:

Neni 2: BE duhet të promovojë... barazinë ndërmjet burrave dhe grave.

Neni 3 (2): BE duhet që në të gjitha aktivitetet e saj të... synojë të eliminojë pabarazitë dhe të promovojë barazitë ndërmjet burrave dhe grave.

Neni 13: Këshilli, i cili vepron unanimisht lidhur me një vendim që vjen nga KE, dhe pasi të jetë konsultuar me PE-në, mund të ndërmarrë veprimet e duhura për të luftuar diskriminimin gjinor, racor, etnik, fetar ose mbi besimin, moshor ose të orientimit seksual.

Neni 141: Çdo shtet anëtar duhet të garantojë parimin e pagës së barabartë për punëtorët gra dhe burra për punën e barabartë ose me vlerë të barabartë.

Arritjet më të fundit shihen me miratimin e **Platformës për Arritjen e Barazisë Gjinore ndërmjet Grave dhe Burrave**, në 1 mars 2006, ku KE përkufizoi prioritete e veta dhe planet për veprim për të promovuar politikat e tij deri në vitin 2010.⁹ Gjithashtu, shtetet anëtare miratuan **Paktin Europian për Barazinë Gjinore** që mbështet këmbënguljen e anëtarëve të BE-së për të zbatuar politika gjinore që synojnë të përmirësojnë punësimin, harmonizimin ndërmjet jetës profesionale dhe asaj personale, kujdesin ndaj fëmijëve, etj.¹⁰

Rregulloret zbatohen menjëherë nga të gjitha shtetet e BE-së.

Direktivat gjithashtu duhet të zbatohen menjëherë nga të gjitha shtetet anëtare, por këta të fundit janë të lirë të zgjedhin mënyrat me të cilat i zbatojnë ato.

Vendimet duhet të zbatohen menjëherë nga institucionet ose shtetasit të cilave u drejtohen.

Rekomandimet shërbejnë si udhëzues për shtetet anëtare.

9 Commission of the European Communities, *Report from the commission to the council, the European parliament, the European economic and social committee and the committee of the regions on equality between women and men*, 2007, pg 3.

10 Po aty, f. 4.

Çfarë përfaqëson një Direktivë?

Një Direktivë është një akt legjislativ European, që në momentin që miratohet nga institucionet Europiane duhet të integrohet në legjislacionin e shtetit anëtar të BE-së.¹¹

Direktivat kryesore të BE-së mbi mundësitë e barabarta gjinore janë si më poshtë:

D. 2006/ Direktiva për Përmirësimin e Barazisë Gjinore, e cila riorganizon direktivat e mëparshme të BE-së lidhur me parimin e mundësive dhe trajtimin e barabartë të grave dhe burrave në fushën e punësimit.

D. 2004/ Direktiva për mallrat dhe shërbimet, e cila mundëson akses të barabartë për gratë dhe burrat lidhur me mallrat dhe shërbimet. Kjo direktivë e zgjeron për herë të parë legjislacionin përtej tregut të punës.

D. 2002/73/EC, e 23 shtatorit 2002 mbi zbatimin e parimit të trajtimit të barabartë të grave dhe burrave lidhur me aksesin/ mundësitë në punësim, trajnim profesional dhe promovim, si dhe mbi kushtet e punës. Kjo Direktivë ka amenduar D. 76/207/EEC.

D. 76/207/EEC, e 9 shkurtit 1976 mbi zbatimin e parimit të trajtimit të barabartë të grave dhe burrave lidhur me

¹¹ National Forum of Europe, *Making the European Union Relevant for Women*, Stationery Office: Dublin. 2007, pg 4.

aksesin/mundësinë në punësim, trajnimin profesional dhe promovimin, si dhe mbi kushtet e punës.

D. 97/80/EC e 15 dhjetorit 1997 mbi peshën/rëndësinë e provës në rastet e diskriminimit bazuar në gjini.

D. 96/97/EC, e 20 dhjetorit 1996 mbi zbatimin e parimit të trajtimit të barabartë për burrat dhe gratë në skemat e sigurimit social të punësimit. Kjo Direktivë ka amenduar D. 86/378/EEC.

D. 86/378/EEC, e 24 korrikut 1986 mbi zbatimin e parimit të trajtimit të barabartë për burrat dhe gratë në skemat e sigurimit social të punësimit.

D. 96/34/EC, 3 korrikut 1996 mbi kornizën e marrëveshjes lidhur me lejen prindërore.

Neni 16 (1) i D. 89/391/EEC dhe D. 92/85/EEC të 19 tetorit 1992 mbi zbatimin e masave që inkurajojnë përmirësime në sigurinë dhe shëndetin në punë të punonjëseve shtatzëna dhe punonjëseve që sapo kanë lindur ose kanë fëmijë në gji.

D. 86/613/EEC e 11 dhjetorit 1986 mbi aplikimin e parimit të trajtimit të barabartë të burrave dhe grave të angazhuar në një veprimtari, përfshirë bujqësinë, në kapacitetin e vetëpunësimit dhe mbi mbrojtjen e gruas së vetë-punësuar gjatë shtatzënisë dhe mëmësisë.

D. 79/7/EEC e 19 dhjetorit 1978 mbi zbatimin progresiv të parimit të trajtimit të barabartë të burrave dhe grave në çështjen e sigurimit social.

D. 75/117/EEC e 10 shkurtit 1975 mbi përafrimin e ligjeve të shteteve anëtare lidhur me aplikimin e parimit të pagës së barabartë për gratë dhe burrat.

Është e rëndësishme të kuptohet që Direktivat, në mbështetje dhe në përputhje me Traktatet, amendohen dhe pasurohen vazhdimisht për t'i hapur rrugë demokracisë dhe zhvillimit. Si shembull, në tetor 2005 filloi procesi i amendimit të D. 2002/73/EEC, e cila më parë kish amenduar D. 76/207/EEC, në fushën e trajtimit të barabartë në vendin e punës. Kjo direktivë u përfundua në 2006.

2.2 Integrimi gjinor

Që nga viti 1995, BE ka aplikuar parimin e integritit gjinor si një mënyrë për të arritur barazinë ndërmjet burrave dhe grave. Integrimi gjinor në terma konkretë përkthehet në: përfshirjen e perspektivës gjinore në hartimin e politikave shtetërore të të gjitha fushave, duke patur parasysh pasojat e tyre për gratë dhe burrat.

Politikat jo legjislative të BE-së në fushën e barazisë gjinore

Si shtesë e legjislacionit parësor, ekzistojnë dhe legjislacione të tjera dytësore. KE, në vitin 2006, skicoi një “platformë” ku identifikohen sfidat dhe veprimet konkrete që BE duhet të ndërmarrë deri në vitin 2010 për të zvogëluar hendekun ekzistues ndërmjet dy gjinive. Për më tutje janë bërë amendime të “*acquis communautaire*” për ta përshtatur atë në funksion të realitetit ku gjendet BE në ditët e sotme, sikurse dhe janë krijuar institucione të veçanta që trajtojnë barazinë gjinore. Në vazhdim të kësaj ideje është krijuar në vitin 2006 Instituti Europian për Barazinë Gjinore dhe është adoptuar një plan i përbashkët për integrimin e qytetarëve të vendeve që nuk i përkasin BE-së. Ky plan synon t’i ndihmojë këto vende lidhur me fenomenet e emigrimit, trafikimin e qenieve njerëzore, punësimin e detyruar, e më tutje.¹² Para kësaj ishte Platforma Komunitare Strategjike për Barazinë Gjinore (2001-2005) ku ishin artikuluar një spektër të gjerë çështjesh si: barazia në jetën ekonomike, përfaqësimi i barabartë në politikë, përfitimi i plotë i të drejtave sociale si për gratë edhe për burrat, nxitja e barazisë në jetën publike si dhe promovimi i ndryshimit progresiv të roleve gjinore dhe stereotipave gjinorë.

Përveç kësaj, Strategjia e Lisbonës (2000) është një tjetër ‘shtesë’ e këtij legjislacioni, ku një pjesë e rëndësishme e saj është Strategjia Europiane e Punësimit, e cila e përcakton barazinë gjinore si thelbësore për të përballuar vështirësitë

¹² Ditmir Bushati, *EU Integration Process-Means to Advance, Aleanca Gjinore për Zhvillim* Shkolla Verore korrik 2007.

që hasen në funksionimin normal të tregut të lirë. Ky lloj angazhimi konsiston në nxitjen e barazisë gjinore në të gjitha aspektet jetike dhe në integrimin në jetën politike, duke i dhënë mundësi të reja gjinisë së nënpërfaqësuar. Kjo Direktivë gjithashtu promovon “ngritjen e sistemeve kombëtarë për të nxitur, analizuar, monitoruar dhe mbështetur trajtimin e njëjtë të të gjithë njerëzve, pa diskriminuar në bazë të gjinisë.”¹³

Barazia gjinore në tregun e punës dhe Strategjia Europiane e Punësimit

Direktiva 2002/73/EC ka arritur qëllime të konsiderueshme në fushën e përshkrimit të termave diskriminues dhe të politikave apo institucioneve që eliminojnë të tilla dukuri, si për shembull, të ngacmimit seksual në vendin e punës, lejen e lindjes, etj. Një nga parimet themelore të Direktivave të BE-së është arritja e barazisë gjinore në tregun e punës. Në ditët e sotme, gratë e punësuarat në shtetet e BE-së paguhen mesatarisht 15% më pak se burrat për punën e bërë me vlerë të barabartë.¹⁴ Në vitin 2005, përqindja e grave të punësuarat u rrit për të 12-in vit radhazi për të arritur në 56.3%, ndërsa për gratë mbi moshën 55 vjeçare u rrit për të arritur 33.7%. Hendeku i punësimit ndërmjet burrave dhe grave varet

¹³ Equal Opportunities for Women and Men: Monitoring law and practice in new member states and accession countries of the European Union, Open Society Institute Network Women’s Program, 2005 pg 13.

¹⁴ National Forum of Europe, Making the European Union Relevant for Women, Stationery Office: Dublin. 2007, pg. 6.

shumë nga grupmosha, por duhet pasur parasysh gjithashtu se gratë kanë tendencën të jenë më tepër të punësuara me kohë të pjesshme ndërsa burrat me kohë të plotë, ku rreth 32.9% e grave punojnë me kohë të pjesshme ndërsa për burrat përqindja është 7.7% (viti 2006).¹⁵ Tre subjektet më interesante të këtij ligji (e përmendur më sipër) janë: (a) Pagesa e barabartë për punë të barabartë¹⁶, (b) Mbrojtja e veçantë e grave shtatzëna dhe leja e lindjes për të dy prindërit si dhe (c) Veprimi Afirmativ.

(a) *Pse gratë paguhen më pak se burrat dhe pse është kaq e vështirë të gjesh gra në profesione prestigjioze?* Siç e kemi vënë re gratë janë më shpesh të përfshira në sektorët administrativë dhe shërbimet, shkollat, industrinë tekstile, etj., ndërsa në ushtri, polici, shkencë dhe teknologjinë e sofistikuar mbizotërojnë burrat. Parimi i pagës së barabartë për punë të barabartë u shqyrtua në Marrëveshjen e Romës në 1957, ku gjithashtu u hodhën bazat për të ardhmen e BE-së.

(b) Direktivat që kanë të bëjnë me mbrojtjen e grave shtatzëna dhe nënave të reja garantojnë trajtimin e barabartë të dy gjinive ku dhe autorizohet leja e lindjes për të dy prindërit. Nën këto rregulla, diskriminimi i grave shtatzëna konsiderohet forma më e hapur e diskriminimit të bazuar në të qenit grua.

15 Commission of the European Communities, *Report from the commission to the council, the European parliament, the European economic and social committee and the committee of the regions on equality between women and men*, 2007, pg 7.

16 Pagesa e barabartë për punë të barabartë do të thotë se pagesa për të njëjtën punë do të matet gjatë të njëjtës periudhë kohe, me të njëjtat kushte dhe të njëjtat segmente pagash. Ky parim është i vlefshëm dhe për sektorin privat.

Gjithashtu, sipas kësaj direktive, shtatzënia dhe të qenit nënë nuk duhet të merren parasysh për vlerësimin e aftësive të një individi që aplikon për një vend pune.

(c) Direktiva e veprimit afirmativ bazohet në faktin se jo të gjithë grupet (përfshirë dhe gratë) mund t'u përshtaten rregullave standarde, prandaj ato duhen ndryshuar për të qenë më elastike. "I njëjti trajtim i personave të pabarabartë çon në diskriminim, ashtu sikurse dhe trajtimi i pabarabartë i personave të barabartë do të thotë diskriminim." Në planin e veprimit të kësaj direktive parashtrihen dhe shqetësime të tilla si: kualifikimet e njëjta të dy kandidatëve me gjini të ndryshme dhe mundësitë e pabarabarta që ekzistojnë të trashëguara nga stereotipa si: raca, grupi shoqëror, mosha, etj.

Në vitin 1998, Strategjia Europiane e Punësimit e vendosi çështjen e arritjes së barazisë gjinore si një nga katër shtyllat strukturore dhe mbështetëse të saj, të cilat vijojnë si më poshtë:

1. Aftësia për të krijuar punësim
2. Sipërmarrja dhe iniciativa e lirë
3. Përshtatshmëria, adaptimi
4. Mundësi të barabarta midis gjinive

Në vitin 1999 u propozua që mundësitë e barabarta gjinore të integroheshin/përfshiheshin në të gjitha orientimet e

punësimit.¹⁷ Si rezultat u përcaktuan katër aspekte kryesore:

- Perspektiva gjinore në punësim
- Vënia në shënjestër e zvogëlimit të hendekut gjinor në punësim
- Harmonizimi i punës dhe jetës familjare, kujdesi kundrejt fëmijëve (duke përfshirë lejen e paguar për prindin mashkull)
- Krijimi i lehtësirave për integrimin në tregun e punës (duke trajtuar posaçërisht diskriminimin dhe ngacmimin seksual në vendin e punës)

Për herë të parë, në mënyrë të qartë e të artikuluar, iu kërkua shteteve anëtare të BE-së të integrojnë perspektivën gjinore në të gjitha shtyllat e Strategjisë Europiane të Punësimit, pa e lënë dimensionin e mundësive të barabarta gjinore të veçuar. *“Kjo kërkon integrimin e dimensionit të përkatësisë gjinore në politika më të gjera se sa politika “klasike” e mundësive të barabarta gjinore.”*¹⁸

Politikat e punësimit janë ato që ndeshen më shpesh kur flasim për politikat e BE-së për arritjen e barazisë gjinore. Por BE ka disa politika dhe strategji të hartuara dhe në fushën e arsimit dhe trajnimit, duke përmendur këtu dhe Kartën e Bolonjës (njësimin e sistemit arsimor), në fushën e institucioneve,

17 COM (1999) 106 final, Brussels, March 5th 1999, *1998 Annual report from the Commission on Equal Opportunities for Women and Men in the European Union*, f. 14.

18 Po aty, f.17.

politikave dhe sigurimit të shëndetit publik, në fushën e të drejtave të njeriut, emigrimit, trafikimit të qenieve njerëzore, etj.¹⁹

2.3 Mbështetja Financiare

Në ditët e sotme, krijimi i Fondit Social European i dalë nga Traktati i Amsterdimit për të ofruar ndihmë financiare për të arritur politikat sociale të BE-së dhe zbatimi i direktivave përkatëse ka mundësuar që disbalancat gjinore të shihen dhe të trajtohen të ndara si më poshtë:

- Synimi për të arritur barazinë në pagesë;
- Synimi për të arritur barazinë në trajtim (kushtet e punës, minimizimi i diskriminimit, etj.);
- Synimi për të ndërtuar një sistem sigurimesh shoqërore gjithëpërfshirës;
- Synimi për të zbatuar strategjitë dhe planet e veprimit që janë hartuar për të mbështetur ligjet ekzistuese. Ndër to vlen të përmenden pjesëmarrja në vendimmarrje e grave (objektivi minimal 40%), eliminimi i diskriminimit në punë, në jetën sociale, politike, dhe synimi për të ndryshuar stereotipat dhe rolet gjinore nëpërmjet arsimit dhe fushatave ndërgjegjësuese.²⁰

19 Për më shumë informacion drejtohu tek: National Forum of Europe, *Making the European Relevant for Women*, Stationery Office: Dublin. 2007.

20 Ditmir Bushati, *EU Integration Process-Means to Advance, Aleanca Gjinore për Zhvillim* Shkolla Verore korrik 2007.

Fondet Strukturore²¹ përfaqësojnë mjetet kryesore financiare të BE-së për rritje ekonomike dhe kohezion social, për përmirësimin e punësimit dhe integritin si dhe për arritjen e zhvillimeve të qëndrueshme. Propozimet e Komisionit për Fondet e Reja Strukturore janë një angazhim për nxitjen aktive të mundësive të barabarta për gratë dhe burrat përmes gjithë politikave të BE-së. 10 Nene nga 56 që përbëjnë kriteret rregulluese të përgjithshme të dhënies së fondeve janë referenca konkrete në fushën e mundësive të barabarta për gratë dhe burrat. Veç kësaj, përfshirja/integrimi i perspektivës gjinore nuk është më një opsion i mundshëm si më parë, por një detyrim për t'u zbatuar.

Fondet Strukturore aplikohen në disa fusha, ku përmendim punësimin, luftën kundër diskriminimit, luftën kundër dhunës në familje, fëmijëve dhe grave, përmirësimin e arsimit të vajzave dhe grave sidomos në shkencë, etj. Përtej fondeve të dhëna drejtpërdrejt nga BE, vendet anëtare mund të bashkëfinancojnë programe për zhvillimin rural, mbrojtjen dhe përfshirjen sociale, punësimin, etj.

Viti 2000 konsiderohet si viti i fuqizimit të politikës së BE-së nga perspektiva gjinore. Në këtë kontekst, u vendos që të krijohej paketa e barazisë gjinore, e cila do të konsistonte në një kornizë programore, si dhe do të amendohej Direktiva 76/207/EEC mbi zbatimin e parimit të trajtimit të barabartë

²¹ European Regional Development Fund, European Social Fund, and European Agricultural Guidance and Guarantee Fund.

të burrave dhe grave lidhur me mundësitë e punësimit, trajnimin profesional dhe rritjes në karrierë, si dhe kushtet e punës.

Edhe pse BE synon arritjen e barazisë gjinore në të gjitha sferat e veprimtarisë njerëzore, është shumë i nevojshëm përkushtimi i vendeve anëtare për të arritur këtë qëllim në të gjitha institucionet e komunitetit. Si një shembull mund të merret PE, i cili së bashku me KBE mbikëqyr dhe kontrollon institucionet e tjera të BE-së. Për periudhën 2004-2009, PE ka 732 deputetë të zgjedhur për një periudhë 5-vjeçare nga 25 shtete. Sistemi zgjedhor i pjesëtarëve të PE-së varet nga shteti të cilin përfaqësojnë. Edhe pse një element kritik në sferën ekonomike dhe shoqërore të një vendi, barazia gjinore në nivelin e lartë të vendimmarrjes në BE ka ecur përpara me hapa të vegjël. Përfaqësimi në parlament i grave është rritur ndjeshëm vitet e fundit, por përsëri gratë në PE zënë vetëm një të tretën e përfaqësuesve.

2.4 Mekanizma dhe institucione për barazinë gjinore të përdorura nga BE²²

Platforma për Veprim e Pekinit

BE nuk e ka firmosur këtë dokument si një trup i përbashkët, por ratifikimi i kësaj platforme është bërë individualisht nga shtetet anëtare të tij. Mekanizmat që merren me zbatimin e barazisë gjinore në nivelin e BE-së, 10 vjet pas hartimit të PVP-së, janë si më poshtë:

Komiteti për të Drejtat e Grave dhe Barazinë Gjinore, i cili merret me paraqitjen e çështjeve gjinore dhe të drejtat e grave, duke pasur si qëllim integrimin gjinor në politikë-bërjen e BE-së. Gjithashtu, në PE ka një trup legjislativ të angazhuar në krijimin e programeve për mundësi të barabarta dhe çështje të personelit.

Grupi i Nivelit të Lartë për Barazinë Gjinore, qëllimi i të cilit është gjithashtu integrimi gjinor dhe mundësitë e barabarta në legjislacionin dhe politikën e BE-së.

Drejtoria e Përgjithshme dhe Komisionari i Përgjithshëm për Punësim, Punë Publike dhe Mundësi të Barabarta (KE) u krijua në vitin 1995 dhe monitoron arritjet e bëra në fushën e

²² European Women' Lobby 'Beijing + 10 1995-2005 Review of the Implementation of the Beijing Platform for Action by the European Union, November 2004.

barazisë gjinore, si dhe merret me çështje të integritimit gjinor në politikat e KE-së.

Grupi Ndër-Shërbimor për Barazinë Gjinore për të përmirësuar bashkëpunimin ndërmjet departamenteve për sa i përket çështjeve gjinore (KE).

Komiteti i Këshillimit për Mundësitë e Barabarta për Gratë dhe Burrat, i përbërë nga përfaqësues të administratës kombëtare dhe partnerë socialë për të pasur një strategji monitoruese dhe mënyra bashkëpunimi ndërmjet vendeve anëtare (KE).

Njësia për Mundësitë e Barabarta për Gratë dhe Burrat, si dhe Njësia “Gratë dhe Shkenca” (KE).

Buxhetimi Gjinor, duke përfshirë perspektivën gjinore në fazën e hartimit të buxheteve për të parë ndikimin tek gratë dhe tek burrat.

3. Integrimi në BE – një proces i komplikuar.

Praktikat e nxjerra nga vendet anëtare dhe kandidatet

Në mars të vitit 1998, BE formalisht hapi procesin që bënte të mundur anëtarësimin në BE të vendeve nga Europa Qendrore. Vendet kandidate duhet detyrimisht të pranorin të njëjtat vlera dhe objektiva që ka identifikuar BE dhe që janë përcaktuar në Traktatet themelues të BE-së.

Për më tepër, KBE përcakton që:

- Përputhja me kriteret politike të shprehura në KBE të Kopenhagenit është një parathënie për hapjen dhe fillimin e negociatave.

Ecuria në negociatat për asociim me BE-në shkon paralel me progresin në trupëzimin e “Acquis communautaire” në legjislacionin vendas dhe në zbatimin e tij në praktikë. Çdo vend aplikant duhet të prezantojë pozitën e tij për secilin nga 31 kapitujt e “Acquis communautaire”, pra jo thjesht Traktatet kryesore të themelimit të BE-së (Traktati i Maastrihit, Romës,

Amsterdami), por edhe të gjitha ligjet dhe rregullat dytësore që rrjedhin prej tyre.

Në këtë kuptim, parimet themelore dhe parashikimet ligjore që përcaktojnë mekanizmat e zbatimit të tyre duhet të përfshihen në kornizën ligjore dhe institucionale të vendit aplikant. Rrjedhimisht, parimi i barazisë midis burrave dhe grave, si dhe parimi i mundësive të barabarta për burrat dhe gratë, duhet të integrohet dhe të zhvillohet në mënyrë të përshtatshme nga vendi aplikant, si kusht paraprak dhe i pakontestueshëm për anëtarësim në BE.

3.1 Përse nuk mund të arrihet integrimi në BE jashtë kornizës së barazisë gjinore dhe asaj të mundësive të barabarta?

Nëse procesi i asociimit për anëtarësim në BE detyron vendin aplikant të integrojë “Acquis communautaire” në legjislacionin e tij dhe në kornizën institucionale përkatëse, atëherë rrjedhimisht kjo parashikon integrim total të “Acquis communautaire”, ku barazia dhe mundësitë e barabarta gjinore janë pjesë e paketës legjislative.

Në këtë kuptim, raporti i KE-së mbi mundësitë e barabarta midis grave dhe burrave në BE, 1998,²³ përcakton qartë në Seksionin 5 - Barazia Gjinore dhe zgjerimi i BE-së që:

23 COM (1999) 106 final, Brussels, 05.03.1999.

“Dimensioni social është një element thelbësor për Komunitetin dhe barazia gjinore e mundësitë e barabarta janë pjesë integrale e dimensionit social. **Nuk ka anëtarësim pa mundësi të barabarta për gratë dhe burrat**”.²⁴

Duke bazuar në mungesë në ekuilibrit gjinor që vihet në jetën e përditshme të BE-së dhe të vendeve kandidate, u konstatua se barazia gjinore duhet të fillojë në nivelin strukturor, duke angazhuar në këtë mënyrë një seri aktorësh socialë. Duke u bazuar tek Nenet 2 dhe 3 të Traktatit të Amsterdimit ku kërkohet barazi ndërmjet dy gjinive si një nga aktivitetet më të rëndësishme të BE-së, është marrë si çështje parësore dhe detyrim ligjor integrimi gjinor në të gjitha aspektet për vendet pjesëtare të BE-së. Në mënyrë që të thjeshtësohet procesi për vendet kandidate, KE ka përmbledhur këshilla dhe çështje me interes (në një udhërrëfyes sugjerimesh praktike) lidhur me integrimin gjinor nën politikën e Memorandumit të Përbashkët për Pjesëmarrjen Sociale (Joint Memoranda on Social Inclusion). Ky memorandum është firmosur nga vendet anëtare për 10 vendet kandidate për hyrje në BE (në 2004) nga KE dhe autoritet e vendeve përkatëse. Për sa i përket Bullgarisë dhe Rumanisë, zhvillimi i planit të punës së Memorandumit të Përbashkët për Pjesëmarrjen Sociale u përfundua para hyrjes së tyre në BE në janar të vitit 2008. Kjo marrëveshje apo memorandum është jetike në zbatimin

²⁴ Heidi Hautala and Commission Representatives 8.10.1998 in Bled, Slovenia, cited in the *1998 Report of the Commission on Equal Opportunities for Women and Men in the European Union*, pg. 28.

e planeve kombëtare të pjesëmarrjes sociale çdo dy vjet. Ky udhërrëfyes praktik i KE-së është një pikënisje e zbatimit të planeve të integritit gjinor në politikë-bërje dhe programet sociale dhe ato të punësisimit. Pas hyrjes në BE, mekanizma të tjera ingranohen për të mundësuar përmirësimin e ekuilibrit gjinor në jetën e vendit dhe për të arritur synimet e BE-së lidhur me barazinë gjinore.

Hyrja në BE përbën për shumë vende të Europës Lindore një ëndërr të vjetër, për të cilën duhet punuar dhe arritur shumë në fazat fillestare të procesit të realizimit. Për këtë arsye, 10 vendet e reja anëtare të BE-së paraqitën planet e tyre kombëtare për varfërinë dhe pjesëmarrjen sociale në Korrik të 2004. Lituania dhe Republika Çeke kishin ndërmarrë posaçërisht politika që adresonin çështjet e integritit gjinor në vendet e tyre dhe aparatet përkatës që mbikëqyrnin masat e marra për ri-strukturimin e jetës profesionale dhe familjare. Problemi më i madh i vendeve të Europës Qendrore dhe Lindore sipas Anita Seibert, (përfaqësuese e një grupi të OJQ-ve të këtij rajoni) mbetet ri-strukturimi i tregut të punës, pasi është vënë re se ka rënë ndjeshëm shkalla e përfshirjes së grave në ekonomi gjatë periudhës së tranzicionit.

Kuptohet që vendeve të reja të anëtarësuar në BE u është ofruar ndihmë e madhe monetare dhe udhërrëfyes në legjislaturë për të nxitur çështjet e barazisë gjinore, duke mos lënë pas dore efektet negative të reformave ekonomike. Edhe pse nxitja e mundësive të barabarta ishte një prioritet,

zhvillimi ekonomik dhe reformat e ndërmarra ndëshkuan përsëri krahun e punës së gruas, pasi hyrja në BE konsiston në arritjen e një niveli ekonomik të detyrueshëm për të përbëlluar tregun European. Më tutje, Ms. Seibert konstatoi se ka ekzistuar shumë pak vullnet politik në fushën e ligjbërjes dhe vendimmarrjes për sa i përket çështjeve të barazisë gjinore, duke qenë se ekziston një mungesë informacioni mbi të tilla ligje. Ajo krahason Poloninë dhe Slloveninë në këtë aspekt, duke thënë se Sllovenia ka hedhur hapa më të mëdha përpara nga vetë fakti se Sllovenët kanë më shumë respekt për ligjin.²⁵ Kjo tregon se për të arritur objektivat, është e nevojshme vendosja e një shteti ligjor dhe vullneti politik i një vendi. Në mënyrë që zbatimi i legjislaturës të arrihet, BE është angazhuar në instalimin e trupave ligjorë të barabartë në të gjithë vendet e përfshira, kështu dhe të monitorohet ecuria dhe të përmirësohet aksesimi ndaj informacionit. N.q.s. një vend anëtar i BE-së nuk angazhohet në zbatimin e Direktivave përkatëse, atëherë KE ndërmerr procedura kontrolli. Kështu, si hap i fundit i monitorimit dhe dialogut me qeverinë mbetet GJED. Parimet e GJED-së lidhen drejtpërdrejt me zbatimin e ligjit të BE-së, i cili ka prioritet mbi ligjet e veçanta shtetërore të vendeve që bëjnë pjesë në të. Vendimet e GJED-së përbëjnë një detyrim për vendet dhe institucionet anëtare të BE-së.

25 The Enlarged European Union and Its Agenda for a "Wider Europe": What Considerations for Gender Equality? A report of a WIDE hearing held at the European Parliament, Brussels, 2 December 2004.

Për vendet e interesuara për anëtarësim, BE përveç parashtrimit të kërkesave parapërgatitore, gjithashtu mbështet strategji për të konceptuar më mirë angazhimet e programeve për dhënien e mundësive të barabarta për burrat dhe gratë. Një nga programet e monitorimit për barazinë gjinore ishte iniciativa e Fondacionit të Shoqërisë së Hapur (SOROS) në Rumani dhe Programi i Rrjetit të Grave i këtij Fondacioni. Ky program monitoroi ecurinë e procesit të çështjeve të përkatësisë gjinore në vendet kandidate për hyrje në BE në vitin 2004. Një shqyrtim i situatës reale bëri që të merreshin masa paraprake për të zbatuar angazhimet që këto vende kishin marrë përsipër me synim hyrjen në BE. Ballafaqimi i situatës u bë duke pasur si bazë parimore Direktivën e BE-së mbi mundësitë e barabarta dhe legjislacionin, institucionet dhe praktikat e vendeve përkatëse. Pra, ligji dhe praktika e BE-së u morën si bazë për arritjen e synimeve që vendet kandidate duhet të përmbushin kohë përpara hyrjes në BE.

Iniciativat kryesore të ndërmarra në nivelin kombëtar nga vendet anëtare të BE-së nuk përqendrohen vetëm tek gratë por dhe tek burrat. P.sh. është e rëndësishme të theksohet se në nivel kombëtar duhet të ketë mekanizma të cilat nuk i përjashtojnë burrat nga strukturat ekzistuese por përpiqen të ndërtojnë mekanizma të cilat krijojnë atmosferë bashkëpunimi ndërmjet dy gjinive.²⁶

²⁶ Advisory Committee on Equal Opportunities for Women and Men, *Opinion on Men in Gender Equality*, 2006, pg2.

Praktikat më të mira të vendeve anëtare teksa ishin në fazën e vendit kandidat janë të shumta. Për shembull, në Qipro Konfederata e Sindikatave publikoi një seri pamfletash dhe publikimesh për punonjësit e saj lidhur me Acquis European mbi barazinë gjinore. Ndërsa në Estoni, një OJF, Fondacioni i Qendrës Ligjore Estone, mundësoi që publiku të shprehte nëpërmjet internetit opinionet e veta lidhur me legjislacionin mbi barazinë gjinore. Në Francë organizohen konferenca të shumta çdo vit për të informuar njerëzit mbi direktivat, ligjet dhe mekanizmat parësore dhe dytësore mbi barazinë gjinore. Në Rumani, në vitin 2003, Qendra për Partneritet dhe Barazi zhvilloi një studim për të identifikuar nevojat për informim të grave mbi tregun e punës, duke identifikuar hendeqet dhe ofruar rekomandime qeverisë, medias, OJF-ve për të përmbushur kriteret e BE-së lidhur me barazinë gjinore. Në këtë mënyrë mund të japim dhe shumë shembuj të tjerë.²⁷

27 Advisory Committee on Equal Opportunities for Women and Men, *The role of civil society in implementing European legislation on equal treatment for women and men in the area of equality at work*, October 2006.

4. Kuadri ligjor dhe mekanizmat kombëtare shqiptare mbi barazinë gjinore

Legjislacioni mbi barazinë gjinore në Shqipëri, ashtu sikurse dhe vetë vendi ka kaluar një periudhë tranzicioni. Por legjislacioni shqiptar është në thelb i sanksionuar sipas standardeve të shoqërive demokratike të përparuara. Ndër të paktët mund të theksohen:

Neni i 18-të i Kushtetutës shqiptare, ku përcaktohet barazia e të gjithë shtetasve përpara ligjit dhe se askush nuk mund të diskriminohet për shkaqe të tilla si: gjinia, raca, feja, etnia, gjuha, bindjet politike, fetare apo filozofike, gjendja ekonomike, arsimore e sociale.

Konventa CEDAW, e cila u ratifikua nga vendi ynë në vitin 1993. Kjo konventë gjithashtu nxit vendet përkatëse të marrin parasysh përmbushjen e detyrimeve që përfshihen aty.

Kodi penal shqiptar i miratuar në vitin 1995 (Ligji Nr. 7905) siguron barazinë mes burrit dhe gruas në të gjitha fushat e jetës, shëndetit, pronës, dhe dinjitetit.

Kodi i punës i miratuar në vitin 2003 njeh të drejta të barabarta për punë midis burrit dhe gruas, për mbrojtjen e gruas në vendin e punës, për pushime të paguara dhe pagesë të barabartë. Ky kod nxit dhe përmirëson gjendjen e punëkërkueseve gra dhe vajza duke stimuluar materialisht punëdhënësin/en.

Kodi i Familjes i miratuar në vitin 2003 (Ligji Nr. 9062) parashikon të drejta të barabarta mes burrit dhe gruas që të zgjedhin lirisht angazhimet martesore dhe divorcin, si dhe të drejtat dhe detyrimet e tyre ndaj familjes dhe edukimit të fëmijëve.

Ligji për Barazinë Gjinore, i miratuar në korrik të 2004-ës plotëson kuadrin ligjor lidhur me të drejtat ligjore mes dy gjinive. Ky ligj u përqendrua në vendosjen e barazisë ndërmjet dy seksëve në fushën e punësimit, arsimit, vendimmarrjes, kundër diskriminimit dhe ngacmimeve seksuale, si dhe në pah dispozitat ligjore në rast se konstatohet shkelja e tij. Ligji është amenduar që nga versioni i tij origjinal dhe është në pritje për t'u miratuar.

Ligji për Masat kundër Dhunës në Familje i miratuar nga Parlamenti Shqiptar në qershor të 2007, për të reduktuar dhunën në familje në vendin tonë. Ligji detyron institucionet shqiptare të marrin masat e nevojshme për t'iu përgjigjur siç duhet këtij fenomeni në Shqipëri. Aktualisht janë duke u hartuar aktet nënligjore përkatëse. Ligji ka një buxhet

të bashkangjitur. Është e rëndësishme të theksohet se ligji u paraqit në parlament me firmën e 20.000 qytetarëve shqiptarë.

Strategjia e Barazisë Gjinore dhe Kundër Dhunës në Familje (2007) dhe Plani për Veprim skicojnë në mënyrë të detajuar të gjitha veprimet përkatëse të organeve qeveritare dhe organizatave të shoqërisë civile me synimin për të arritur barazinë gjinore. Mangësitë e strategjisë përfshijnë shkrirjen e dy strategjive në një të vetme, mungesën e trajtimit të fenomenit të trafikimit të qenieve njerëzore, nuk përcaktohen detyra të veçanta për institucionet përkatëse por trajtohen në aspektin teorik, mungon bashkërendimi institucional për disa objektiva të rëndësishëm, mungojnë treguesit gjinorë dhe buxheti.²⁸

Dispozitat Ndërkombëtare të ratifikuara nga Shqipëria, ku përfshihen, përveç CEDAW-it dhe Kartës Sociale Europiane, edhe Marrëveshja Bazë midis Republikës së Shqipërisë dhe Komunitetit Europian mbi parimet e përgjithshme për pjesëmarrjen e Shqipërisë në programet e Komunitetit.²⁹

Në fillim të vitit 2005, Shqipëria renditej e 103-ta midis 183 shteteve duke u bazuar në Klasifikimin Botëror të Bashkimit Ndër-parlamentar, për sa i përket vendeve që zënë gratë në

28 Ditmir Bushati, *EU Integration Process-Means to Advance, Aleanca Gjinore për Zhvillim* Shkolla Verore korrik 2007.

29 Aleanca Gjinore për Zhvillim, *Drejt Rrugës për në BE- Monitorim i Shanseve të Barabarta për Gratë dhe Burrat në Shqipëri*, Pegi, 2006.

parlament, edhe pse Shqipëria është përfshirë në zbatimin e Deklaratës së Objektivave të Mijëvjeçarit të Kombeve të Bashkuara, ku paraqitet objektivi që në vendin tonë të arrihet barazia gjinore brenda vitit 2015.³⁰

4.1 Mungesa e institucioneve mbështetëse

Në Shqipëri ekzistojnë disa organe përgjegjëse për promovimin e barazisë gjinore, ku mund të përmendim **Komitetin për Barazi Gjinore**, i cili ka një buxhet shumë të vogël përkundrejt përgjegjësive të tij lidhur me promovimin e barazisë gjinore; **Komiteti Ndër-Ministror për Barazinë Gjinore**, i ngritur si rrjedhojë e ligjit për barazinë gjinore të vitit 2004, i cili përveç promovimit të ligjeve dhe mekanizmave për barazinë gjinore duhet të monitorojë punën e Komitetit për Barazi Gjinore; **Avokati i Popullit**, i përcaktuar nga kushtetuta si mekanizëm që mbron të drejtat dhe liritë e qytetarëve duke garantuar barazinë në trajtim nga ana e organeve të administratës publike.

Ashtu siç thuhet dhe në Raportin e Zhvillimit Njerëzor për Shqipërinë të vitit 2005, statusi aktual i grave sot është një dukuri e ndërlikuar, ashtu si dhe problemet që trashëgohen dhe krijohen si rrjedhojë. Hapi i parë fillon tek identifikimi i

30 Politikat dhe Zhvillimi në Dobi të të Varfërve e të Grave në Shqipëri: Vënia në Veprim e Objektivave të Zhvillimit të Mijëvjeçarit, Raporti i Zhvillimit Njerëzor për Shqipërinë 2005.

problemeve të grave shqiptare, ndër të cilat mund të veçojmë varfërinë ekonomike dhe braktisjen e shkollës. Përgjithësisht, shoqëria shqiptare 'u ka caktuar' grave më shumë role sesa burrave; ato duhet të përmbushin rolin prodhues, riprodhues, shoqëror dhe komunitar. Në zonat rurale, përmbushja e këtyre roleve është akoma më e vështirë, pasi kushtet e vështira dhe mentaliteti e ndërlikojnë më shumë situatën. Sjellja e individëve, qofshin këta të fundit gra apo burra, ndikohet në shkallë të lartë nga institucionet politiko-ekonomike të një vendi. Mungesa e institucioneve të tilla krijon boshllëqe dhe një mungesë ekuilibri në segmente të ndryshme të popullatës, ku më pak të mbrojtura nga ligji mbeten gratë dhe vajzat. Të marrim një shembull: në fillim të tranzicionit shumë fabrika dhe kombinatë ku punësoheshin shumica e grave dhe vajzave u mbyllën dhe papunësia u rrit me hapa gjigante, ashtu si dhe në shumë vende të Europës Qendrore dhe Lindore.

Shqipëria është një nga vendet me një popullsi ekonomikisht aktive dhe të re në krahasim me vendet e tjera të rajonit dhe Europës. Sipas INSTAT-it, në një përmbledhje të dhënash të botuar në vitin 2004 (Femra dhe Meshkuj), u konstatua se numri i të punësuarve në Shqipëri arrin në rreth 926.000 persona ose 51% popullsisë aktive për punësim. Nga kjo shifër del se vetëm 39.1% është shifra që tregon pjesëmarrjen e grave dhe vajzave, në krahasim me atë të djemve që konstatohet rreth 62.6%. Duke u nisur vetëm nga këto shifra shihet qartë se dhe pse papunësia në Shqipëri është një dukuri e theksuar, gratë dhe vajzat janë më tepër të ndikuara prej saj. Kuptohet

që ndryshime vihen re në rajone të ndryshme të vendit si dhe nëpër qytete dhe fshatra. Përpos vështirësive për të gjetur vende pune, gratë dhe vajzat ndeshen me diskriminimin gjinor dhe moshor. Pjesa më e madhe e njoftimeve në gazeta kërkojnë vajza nën moshën 25 vjeç për vende pune si asistente, sekretare, etj., ndërsa kur kërkohen menaxherë, preferohen më tepër punëkërkuesit meshkuj.³¹ Gjithashtu, vihet re se gratë janë të punësuara më shumë në sektorin e tregtisë dhe të shërbimeve, duke përfshirë këtu dhe punët që konsiderohen si pjesë e ekonomisë joformale.

Dallimi vihet re në të gjithë grupmoshat ekonomiksht aktive dhe në të gjitha degët e ekonomisë me një ndryshim të vogël në degën e arsimit dhe administratës publike, që përbëhen prej 44% gra dhe vajza. Përveç këtyre, vajzat dhe gratë duhet të përballojnë dhe diskriminimin moshor, i cili vihet re në shtypin e përditshëm ku disa gra të moshës riprodhuese apo mbi një moshë të caktuar nuk mund të punësohen lehtësisht. Për më tepër, gratë dhe vajzat janë shpesh të punësuara në pozicione të ulëta hierarkike. Ky portret nuk ndryshon shumë në sektorin privat, ku pjesëmarrja e grave është akoma në nivele të ulëta. Shpesh kjo dukuri përshkruhet në termat menaxheriale si *'glass ceiling'* ose *'tavani i xhamit/tejdkushëm'* për të përshkruar pamundësitë dhe vështirësitë (sociale dhe strukturore) që hasin gratë dhe vajzat për të arritur postet vendimmarrëse, ku zakonisht ato shohin të ulen burrat. Biznesi privat i drejtuar nga gratë apo vajzat është

³¹ Aleanca Gjinore për Zhvillim, *Drejt Rrugës për në BE- Monitorim i Shanseve të Barabarta për Gratë dhe Burrat në Shqipëri*, Pegi, 2006, fq. 19.

përgjithësisht i përqendruar në qytetet e mëdha si Tirana, Durrësi, Elbasani dhe Lushnja. Sipërmarrja pra nuk shihet akoma si një angazhim në të cilin marrin pjesë në sasi të mëdha gratë dhe vajzat, ndaj dhe vetëm 7% e menaxhereve të bizneseve janë gra.³² Gjithashtu, roli i institucioneve shtetërore dhe financiare nuk i krijon apo mbështet kushtet e duhura për të favorizuar sipërmarrjen e një biznesi nga gratë dhe vajzat, dhe pse në këtë drejtim po vërehen përmirësime.

E si mund të arrijmë në një zhvillim ekonomik kur gjysma e popullsisë (gratë dhe vajzat) janë të diskriminuara në tregun e punës? Cilat janë mekanizmat që mund të ndihmojnë në eliminimin e këtij diskriminimi gjinor?

4.2 Pakti i Stabilitetit dhe Marrëveshja e Stabilizim Asociimit – një mekanizëm rajonal

Nuk mund të harrojmë se Shqipëria është pjesë e rajonit të Ballkanit dhe si e tillë ka përgjegjësi dhe detyrime rajonale. Për shkak të konflikteve të shumta etnike të dekadës së kaluar, si dhe shkallës së ulët të zhvillimit ekonomik dhe infrastrukturor, vendet e Ballkanit kanë krijuar marrëdhënie më të forta tregtare, ekonomike dhe politike me vendet anëtare të BE-së sesa me fqinjët e tyre.³³ Por BE e shikon integrimin e vendeve

³² Po aty.

³³ The European Commission Directorate General for Economic and Financial Affairs "The Western Balkans in Transition", n. 23 – December 2004.

Ballkanase si një proces të ndërlikuar që duhet të ndodhë në nivelin rajonal, duke specifikuar nevojat individuale të çdo vendi. Kjo ishte dhe arsyeja e Paktit të Stabilitetit, ku shprehen qartë interesat e BE-së për stabilitetin dhe sigurinë e rajonit në tërësi dhe jo vetëm ato të vendeve të veçanta. Shqipëria ka qenë një nga vendet më aktive në ideimin e iniciativave të Paktit, si krijimin e zonave të tregtisë së lirë, krijimin e kushteve lehtësuese për shkëmbimin e lirë të mallrave, njerëzve e ideve, mbi reformimin e sistemit të edukimit e të informimit, mbi krijimin e zonave kufitare të çmilitarizuara, por shumë pak është folur për çështjet e barazisë gjinore dhe bashkëpunimin e mekanizmave kombëtarë për të arritur standardet e synuara.³⁴

Shqipëria ka ndërmarrë ratifikimin e një sërë konventash si Konventa Europiane për të Drejtat e Njeriut, për Mbrojtjen e Minoriteteve, për Pushtetin Lokal, Konventa Penale kundër Korrupsionit, si dhe nënshkrimi i Konventës Civile kundër Korrupsionit, këto të fundit të dyja dokumente të KiE-së. Nën ndikimin e Paktit të Stabilitetit dhe Marrëveshjes së Stabilizim Asocimit, mund të themi se këto konventa përbëjnë hapat e parë për ngritjen e një infrastrukture të përbashkët juridike dhe institucionale, që do të ofronte angazhim dhe rezultate në fushën e barazisë gjinore.

34 Pakti i Stabilitetit, nga Ideja në Projekt, Ministria e Punëve të Jashtme <http://www.mfa.gov.al/shqip/pakti.asp> (Parë për herë të fundit në 10 nëntor 2005).

4.3 Kalendari i hapave të Shqipërisë drejt Marrëveshjes së Stabilizim Asociimit:

- 1992 Shqipëria përcaktohet që mund të përfitojë nga fondet e BE-së nën programin PHARE.
- 1999 BE propozon një Marrëveshje të re Stabilizim Asociimi për 5 vende të Rajonit, duke përfshirë këtu dhe Shqipërinë.
- 2000 KBE vendos që vendet e Marrëveshjes për Stabilizim e Asociim janë kandidatë potenciale për anëtarësim në BE.
- 2003 31 janar, KE bën të ditur hapjen e negociatave për Marrëveshjen e Stabilizim Asociimit midis BE-së dhe Shqipërisë.
- 2007 Nënshkruhet nga BE Marrëveshja e Stabilizim Asociimit me Shqipërinë.

Misioni i MSA-së është “krijimi i kuadrit rregullator të marrëdhënieve politike, tregtare dhe ligjore ndërmjet Shqipërisë nga njëra anë dhe Komunitetit European dhe shteteve anëtare të BE-së nga ana tjetër”.³⁵ Objektivat kryesore të Marrëveshjes së Asociimit mbeten forcimi i demokracisë dhe shtetit ligjor, stabiliteti politik, ekonomik dhe institucional si në vend ashtu dhe në rajon, zhvillimi i bashkëpunimit ekonomik ndërkombëtar dhe përafrimi i legjislacionit, krijimi i një ekonomie tregu funksionale duke i dhënë fund tranzicionit, zhvillimi i marrëdhënieve të shëndosha rajonale dhe me BE-në në aspektin politik dhe ekonomik. MSA zbatohet

³⁵ Ditmir Bushati, *EU Integration Process-Means to Advance*, Aleanca Gjinore për Zhvillim Shkolla Verore korrik 2007.

brenda një periudhe 10 vjeçare (5+5) dhe shkalla e zhvillimit në zbatimin e reformave gjatë kësaj periudhe është parakusht për realizimin e asociimit të plotë. Është Këshilli i Stabilizim Asociimit që vendos kalimin e Shqipërisë në fazën e dytë.

Që Shqipëria të kalojë në fazën e dytë, para së gjithash duhet të ndërmarë dhe të përmbushë një sërë reformash në fazën e parë. Ato përfshijnë: “funksionimin e tregut të brendshëm, konkurrencën dhe ndihmën shtetërore, pronësinë intelektuale dhe industriale, prokurimet publike, standardet dhe certifikimet, shërbimet financiare, transportin detar (duke theksuar ndjeshëm sigurinë dhe standardet e mjedisit, si dhe aspektin social), legjisllacionin mbi shoqëritë tregtare, mbajtjen e kontabilitetit, mbrojtjen e konsumatorit, mbrojtjen e të dhënave/privatësia, shëndetin dhe sigurinë në punë, shanset e barabarta, etj.”³⁶ Të gjitha këto rregullohen në bazë të ligjeve të veçanta në veprim dhe nga mekanizmat përkatës, siç është Këshilli i Stabilizim Asociimit, KE, Komiteti Ndërparlamentar dhe nënkomisionet e ndryshme. Pra, nuk mund të themi se mundësimi i shanseve të barabarta për burrat dhe gratë, sikurse dhe për minoritetet, është siguri për kalimin në fazën e dytë të marrëveshjes dhe më vonë të integritetit.

4.4 Përparësitë e MSA-së lidhur me Barazinë Gjinore

1. Fillimisht, Shqipëria duhet të përafrojë legjislacionin e saj (sikurse dhe ta zbatojë atë) me atë të BE-së lidhur me barazinë gjinore (neni 70) i MSA-së.
2. Vëmendje të veçantë zë përafrimi i legjislacionit dhe zbatimi i tij për sa i përket kushteve të punës, veçanërisht shëndetit dhe sigurisë në punë duke ofruar mundësi të barabarta (neni 77).
3. Bashkëpunimi social ndërmjet KE-së dhe Shqipërisë për të përafuar dhe zbatuar legjislacionin lidhur me fushat e përmendura më sipër, duke marrë si bazë nivelin e mbrojtjes që ekziston aktualisht në Komitetin Europian dhe fushat parësore të *acquis communautaire* (neni 99).
4. Bashkëpunimi në fushën e arsimit dhe trajnimit ndërmjet KE-së dhe Shqipërisë për të garantuar akses të njëjtë në të gjitha nivelet e arsimit dhe trajnimit, duke reduktuar në maksimum të gjitha format e diskriminimit (neni 100).

Rezoluta e tetorit e vitit 2006 e PE-së dhe Raporti i KE-së në nëntor të të njëjtit vit u rekomandojnë autoriteteve shqiptare se duhet të propozojnë strategji të reja për të luftuar dhunën kundër grave dhe fëmijëve dhe atë që ushtrohet në familje, sikurse dhe të rrisin përpjekjet e tyre lidhur me luftën kundër trafikimit të qenieve njerëzore, duke krijuar streha dhe qendra rehabilitimi për viktimat. Për më tutje, diskriminimi në pagë dhe kushtet e punës (*sidomos* për gratë shtatzëna) nuk janë në nivelin e duhur dhe për faktin se legjislacioni shqiptar

nuk përkufizon qartë diskriminimin e drejtpërdrejtë dhe atë të tërthortë, gratë nuk marrin pjesë në mënyrë aktive në jetën sociale dhe atë politike dhe mekanizmat ekzistues për zbatimin e këtyre politikave sociale janë shumë të dobëta dhe nuk kanë qenë efikase.³⁷

4.5 Objektiva, synime dhe mekanizma

Integrimi me Bashkimin Europian dhe përshtatja e legjislaturës së vendit me atë të BE-së është një nga prioritetet politike të vendit tonë. Të drejtat e individit, të shumë përfolura këto, kanë kategorizuar shtypin dhe si një parim që duhet zbatuar patjetër për hyrjen në BE. Por dihet se përshtatja e legjislaturës shqiptare me atë Europiane nuk është i vetmi problem që pengon Shqipërinë për t'u anëtarësuar, pasi vendi ynë është mbrapa në një sërë çështjesh.

Zbatimi i kësaj legjislature mbetet një sfidë dhe për vetë vendet e reja, që tashmë bëjnë pjesë në BE dhe e kanë miratuar këtë legjislacion. Pak flitet për çështjet e përkatësisë gjinore dhe zbatimin e tyre, si një pjesë e konsiderueshme e të drejtave të njeriut. Kur shpesh dëgjohet të flitet për reforma të sistemit ekonomik dhe paraqitjen e mekanizmave të një ekonomie të hapur, ndërkohë që lihet mënjanë institucionalizimi i parimit të trajtimit të njëjtë të të dy gjinive në tregun e punës dhe ri-strukturimit të burimeve monetare dhe njerëzore. Edhe pse

dukuria e reformave ekonomike sjell në vetvete një “gëzim” për të ndryshuar situatën aktuale, nuk duhet anashkaluar fakti se sidomos në vendet në tranzicion, reforma të tilla ndikojnë në mënyrë jo të barabartë të dy gjinitë.

Ashtu si në Shqipëri, është vënë re se në vendet në tranzicion gratë e kanë kaluar këtë proces me më shumë vështirësi sesa burrat nga fakti se vendimmarrësit dhe ligjbërësit shpesh shohin si diskriminim trajtimin e njëjtë të dy gjinive të ndryshme. Në këtë rast, integrimi i Shqipërisë në BE mund të ndikojë negativisht në strukturën shoqërore nëse nuk merren masa për të ndaluar efektin e reformave ekonomike që ndikojnë në rolin e grave në tregun e punës. Duke u bazuar tek eksperiencia e vendeve të Europës Qendrore dhe Lindore, qeveria shqiptare mund të bashkëpunojë me trupat përkatës të BE për të zbatuar plane që stimulojnë angazhimin e gruas në tregun e punës si dhe sigurojnë zhvillimin ekonomik për të cilin vendi ynë ka aq shumë nevojë.

Një nga sfidat kryesore mbetet gjendja gjithmonë e në ndryshim e direktivave dhe mekanizmave që zhvillohen nga BE lidhur me barazinë gjinore, pasi në vendet ish-komuniste, barazia gjinore nuk është parë si e rëndësishme dhe nuk kanë ekzistuar më parë mekanizma që funksiononin për ta arritur atë. Gjithashtu, ekziston një lidhje e dobët ndërmjet shtetit dhe shoqërisë civile, duke e bërë zbatimin e ligjeve në praktikë më të vështirë. Duhet theksuar kësaj se faktori bazë për ngritjen e infrastrukturës ligjore dhe asaj praktike mbetet vullneti

politik dhe se janë pikërisht shtetet anëtare ose kandidatë, përgjegjëse për të promovuar barazinë gjinore në të gjitha nivelet, pa pritur nga BE t'i udhëzojë në çdo hap. Praktikën më të mira nxirren pikërisht nëpërmjet studimit të kontekstit të veçantë të çdo kulture dhe aplikimit të mekanizmave që funksionojnë më mirë në atë kontekst.

Vendi ynë është përpjekur t'i përgjigjet rekomandimeve të bëra nga PE dhe KE lidhur me politikat sociale që synojnë arritjen e barazisë gjinore, duke punuar sidomos në fushën e përafrimit të ligjeve, veçanërisht në fushën e shëndetit dhe të sigurisë në punë për të ofruar mundësi të barabarta. Në vitin 2006 u hartua Strategjia kundër Dhunës në Familje e cila në vitin 2007 u shkri me Strategjinë për Barazi Gjinore. Zbatimi pritet të fillojë së shpejti. Pavarësisht se në këtë rast qeveria u përpoq t'u përgjigjej sugjerimeve të PE-së dhe KE-së, në pjesën tjetër të rasteve kjo gjë nuk shihet si prioritet. Përpos të gjithave, mungon caktimi i buxhetit përkatës dhe mekanizmave funksionalë për zbatimin e këtyre strategjive dhe planeve për veprim.

Një nga angazhimet e politikëbërësve shqiptarë mbetet, pra zbatimi i ligjeve dhe mekanizmave joligjore (strategjitë dhe planet për veprim) të miratuara tashmë, të cilat do të përmirësojnë statusin e nivelit të grave në shoqërinë tonë, duke fuqizuar një mekanizëm kundër diskriminimit gjinor, si dhe zbatimin e të drejtave të njeriut, të cilat duhet t'i përmbushim patjetër për t'u zhvilluar. Për të na udhëhequr në

këtë drejtim, kemi një seri dokumentesh, të cilat janë ratifikuar dhe përdoren nga vendet anëtare të BE-së dhe përbëjnë një udhëzim praktik drejt standardeve të vendeve të zhvilluara.

4.6 Arritja e Objektivave të Zhvillimit të Mijëvjeçarit në bashkëpunim me Konventën CEDAW dhe PVP

Fatmirësisht, Konventa CEDAW dhe PVP kanë paraqitur një udhëzim të detajuar në çështjet e përgjithshme për të drejtat e grave dhe vajzave dhe përkatësisë gjinore, duke qenë kështu udhërrëfyes për zbatimin e Objektivave të Mijëvjeçarit. Një nga çështjet themelore mbetet identifikimi i mënyrave sesi këto tre korniza ligjore të bashkëpunojnë me mekanizmat kombëtare të barazisë gjinore dhe të ndihmojnë dhe mbështesin njëra – tjetrën, duke marrë parasysh ndryshimet kulturore, ekonomike dhe politike të çdo vendi. Duhet mbajtur parasysh se barazia gjinore është një fenomen që nuk mund të arrihet nga vendosja e një ligji, por vjen si rezultat i funksionimit efikas të strategjive të ndryshme, të cilat, të integruara së bashku, krijojnë një imazh të plotë në çdo aspekt të shoqërisë, qoftë ai ekonomik, politik apo kulturor.

4.7 Pjesët përbërëse të Programit për Mundësi të Barabarta të OZHM-së

Lufta ndaj varfërisë së skajshme dhe urisë

Objektivi i Parë i Mijëvjeçarit është zhdukja e varfërisë, e cila në Shqipëri, ashtu si dhe në shumë vende të botës, ka një peshë më të madhe mbi gratë dhe fëmijët. Pamundësia ekonomike dhe aftësitë e pazhvilluara të një individi e bëjnë shumë të vështirë daljen nga varfëria e tejskajshme. Përrjashtimi i grave nga nivelet e ndryshme të arsimit dhe mekanizmat e shërbimit social dhe shëndetësor, në bashkëpunim me rishëruarimin e ekonomisë së tregut, e bëjnë tejet të vështirë përmirësimin e aftësive të grave. Pra, ky mohim i të drejtave themelore të grave krijon një pengesë në përmirësimin e përgjithshëm të situatës së një vendi në zhvillim. Aksesit ndaj shërbimeve publike apo dhe aksesit ndaj informacionit shpesh kufizon aftësitë e grave për veprim, edhe pse legjislatura për dhënien e mundësive e barabarta mund të jetë vendosur. Është e nevojshme të kuptohet se zhvillimi ekonomik i një vendi nuk është një ilaç për shërimin e problemeve gjinore.

Këto të fundit do të vazhdojnë derisa të drejtat e grave dhe vajzave të jenë garantuar. Në Konventën CEDAW dhe PVP Shqipëria është e detyruar dhe angazhohet në garantimin e të drejtave të grave dhe aksesit ndaj burimeve që janë kritikë në uljen apo eliminimin e varfërisë. Këto dy platforma garantojnë barazinë në çdo aspekt të punësimit, të drejtës së pronës, kontratat dhe kreditë nëpërmjet institucioneve

financiare në jetën publike si dhe në atë private (të martesës dhe jetës në familje). Grave duhet t'u garantohet aksesimi ndaj tregut, teknologjisë dhe kredive bankare. Një vëmendje e veçantë duhet pasur për gratë që banojnë në zonat rurale, duke theksuar të drejtën e pronës dhe kushtet normale të jetesës.

Kryerja botërore e arsimit bazë

Ky objektivi synon që në vitin 2015 të jetë arritur arsimimi fillestar i të gjithë djemve dhe vajzave. Disa pengesa të llojeve të ndryshme ekzistojnë në arritjen e barazisë në nivelin fillestar të arsimit, ndër të cilat mund të renditen: puna në shtëpi dhe në fermë si dhe mentaliteti, i cili pengon investimin në edukimin e vajzave. Për këto arsye, masa parandaluese duhen marrë shpejt duke ulur shpenzimet e shkollimit, gjë e cila është provuar të ketë pasur rezultate pozitive në edukimin e vajzave. Qeveria shqiptare, si pjesëtare e Konventës CEDAW dhe PVP, është e detyruar dhe angazhuar të sigurojë barazinë në të gjitha nivelet e arsimit, si dhe në programet për të eliminuar analfabetizmin dhe trajnimin teknik dhe profesional. Kjo do të thotë që përveç arritjes së barazisë së edukimit, vajzat dhe gratë të jenë të mbështetura të vazhdojnë edukimin e tyre në mënyrë të barabartë me djemtë.

Aktualiteti i barazisë gjinore në arsim në Shqipëri

Niveli arsimor i grave dhe vajzave në Shqipëri është një nga treguesit më të mirë të suksesit të individit si pjesëtar i shoqërisë. Në bazë të rezultateve të nxjerra nga INSTAT, në Shqipëri vajzat janë më të suksesshme se djemtë në të gjitha nivelet e arsimit. Në arsimin e mesëm dhe të lartë vihet re se në fund të vitit ka më shumë studente vajza sesa djem edhe pse në fillim të vitit është e kundërta. Duke u bazuar përsëri tek të dhënat e INSTAT-it, del se pavarësisht nga arritja e vajzave shqiptare në arsim, fakti mbetet që niveli arsimor i grave dhe vajzave në Shqipëri mbetet më i ulët se në vendet e tjera të Europës.

Braktisja e shkollës është një fenomen i ri i shoqërisë shqiptare, duke ndikuar secilën gjini në mënyrë të ndryshme. Faktori kryesor për vajzat për braktisjen e shkollës mbetet mentaliteti familjar, që ndikon 9 herë më shumë se sa tek djemtë. Ndërsa kur marrim arsimin e lartë, edhe pse numri i të diplomuarve është më i lartë për vajzat sesa për djemtë në postet drejtuese të universiteteve dhe instituteve shtetërore janë më të dukshëm djemtë dhe burrat. Në arsimin e lartë gratë zënë rreth 40% të personelit mësimdhënës, por vetëm 9% e tyre mbajnë titullin “profesore” në krahasim me 91% të burrave. Këtu ndikojnë disa faktorë, ndër të cilët mund të përmenden përgjegjësitë në familje dhe ndarja gjinore e punës, gjë që çon në pamundësinë për t’u kualifikuar më tutje, vetëvlerësimi i ulët, mentaliteti etj.

Arsimi shihet si një faktor kryesor në emancipimin dhe vetëvlerësimin e grave në shoqëri dhe është i nevojshëm të shihet si një nga shtyllat mbajtëse të statusit së gruas. Edhe pse nga ekonomistët liberalë shihet si një barrë ekonomike, leja e lindjes dhe kujdesi ligjor për nënat shtatzëna dhe me gji në vendin e punës është një nga stimuluesit kryesorë për gratë, pasi elasticiteti dhe siguria ekonomike bëjnë që shumë gra të kenë mundësi të angazhohen në aspektin profesional të jetës së tyre dhe jo t'i dedikohen vetëm atij familjar.

Një nga strategjitë për të ndryshuar stereotipat mbi rolin e gruas nëpërmjet arsimit, që ekzistojnë si rrjedhojë e mentalitetit shqiptar, është ri-shikimi i teksteve shkollore që nga klasa e parë, përgatitja e një kurrikulumi të ndjeshëm ndaj çështjeve të përkatësisë gjinore dhe trajnime për mësuesit/et mbi këto çështjet.³⁸

Mosbraktisja e shkollës duhet të mbetet një çështje parësore për qeverinë shqiptare. Më tepër stimul material nga ana e qeverisë është shpesh i nevojshëm për të mbajtur nëpër shkolla fëmijët e familjeve të varfra, të cilët janë të detyruar ta braktisin atë për të punuar për të ndihmuar familjen. Zbatimi i një strategjie e tillë është kryer nga disa qeveri në Amerikën e Jugut ku shteti me anë të programeve

38 Plan of Action of the CIM on Women's Participation in Power and Decision-Making Structures, Inter-American Commission of Women.

sociale garanton një shumë prej 50-70 dollarësh familjeve të varfra për të mbajtur fëmijët në shkollë dhe për vizita mjekësore. Nga sondazhet e bëra është nxjerrë përfundimi se këto para janë të buxhetuara më mirë nga gratë në një familje, pasi është vënë re se ato priren ta shpenzojnë këtë shumë për fëmijët e tyre. Dhe pse kjo strategji nuk përbën një zgjidhje të të gjitha problemeve sociale, ka pasur mjaft sukses në Meksikë dhe Brazil, ku shumica e dhënë nuk ka mjaft ndikim për të ndryshuar kërkesën/tregun për punë dhe është e mjaftueshme për të përballuar shpenzimet për ushqimin, shkollimin dhe shëndetin e fëmijëve në familjet e varfra. Kjo ndihmë modeste e shtetit varet nga mbarëvajtja e fëmijëve në shkollë, të cilët kur e braktisin atë shkaktojnë ndërprerjen e kësaj ndihme. Ndikimi ekonomik i një programi të tillë në buxhetin e shtetit është minimale pasi duke marrë shembullin e Brazilit, qeveria shpenzon 0.36% të prodhimit vjetor të brendshëm bruto për të ndihmuar me 50-70 dollarë në muaj 7.5 milionë familje. Një strategji e tillë do të çonte gjithashtu në rritjen e rolit të gruas për sa i përket kontrollit të shpenzimit të burimeve materiale në familje si dhe ndaj fëmijëve, edukimit dhe shëndetit të tyre

4.8 Nxitja e barazisë gjinore dhe fuqizimi i rolit të gruas

Masat që duhen marrë për arritjen e barazisë gjinore dhe fuqizimin e grave janë nënvizuar në disa dokumente dhe konferenca ndërkombëtare³⁹, përveç Konventës CEDAW dhe PVP. Platformat e paraqitura në këto dokumente kërkojnë të adresojnë dimensionet më kritike të arritjes së barazisë gjinore, si p.sh. dhuna ndaj vajzave dhe grave, stereotipat kulturorë, trafikimi dhe prostitucioni, konfliktet e armatosura, jeta politike, legjislacioni, strukturat qeveritare, media, edukimi, punësimi, sigurimi shëndetësor, planifikimi familjar, varfëria, mjedisi i jashtëm, vështirësitë në zonat rurale, martesat dhe marrëdhëniet familjare.⁴⁰ Vihet re sërish se barazia gjinore është një betejë që duhet luftuar në disa fusha, përndryshe mbetet e njëanshme dhe joefikase. E rëndësishme të theksohet është struktura e nevojshme institucionale dhe mjedisi i përshtatshëm, mekanizmat kombëtarë, si dhe fondet monetare për zbatimin dhe mbështetjen e të drejtave të grave.

39 Këtu ia vlen të përmendet Konferenca e Rios për Ambientin dhe Zhvillim (1992), Konferenca e Vienës për të Drejtat e Njeriut (1993), Konferenca e Kairos për Popullsinë dhe Zhvillim (1994), Samiti i Kopenhagenit për Zhvillimin Social (1995), Konferenca e Stambollit për Sistemimin e Njerëzve (1996), Konferenca e Durbanit Kundër Racizmit (2001), dhe Konferenca e Monterreit për Financimin e Zhvillimit (2002).

40 Lee Waldorf 'Pathway to Gender Equality: CEDAW, Beijing and the MDGs' UNIFEM, GTZ and the German Federal Ministry for Economic Cooperation and Development, 2005.

Në tetor të vitit 2004, Instituti i Studimeve Ndërkombëtare studioi për herë të dytë, pas një periudhe 2-vjeçare, administratën publike, median, komunitetin e biznesit dhe organizatat jo-qeveritare në Shqipëri, për të vlerësuar nivelin e njohurive që këto segmente të popullatës kanë mbi BE-në dhe kushtet e integritit të vendit tonë në këtë komunitet. Gjatë këtij sondazhi, u konstatua se njohuritë e të anketuarve mbi kushtet e anëtarësimit të Shqipërisë në BE ishin përmirësuar në krahasim me dy vitet e mëparshëm dhe u vu re se shumë nga të anketuarit tërhoqën vërejtje ndaj mos-angazhimit të aktorëve politikë për t'u qëndruar korrekt reformave ekonomike dhe politike, të cilat do të shpejtonin ecurinë e këtij procesi. Nga të anketuarit u konstatua se disa nga kushtet parapërgatitore të integritit të Shqipërisë në BE ishin: (sipas rëndësisë) lufta kundër korrupsionit, zhvillimi dhe stabiliteti ekonomik, lufta kundër krimit e trafikimit të qenieve njerëzore, realizimi i zgjedhjeve të lira, fuqizimi i shtetit ligjor, reforma të ndryshme, demokratizimi, kontrolli i mirë i kufijve, të drejtat e minoritarëve, përmirësimi i infrastrukturës, ligji mbi pronën private e deri tek regjistrimi i popullatës. Në këtë raport nuk përmenden nga ana e të anketuarve çështje që kanë të bëjnë drejtpërdrejt me barazinë gjinore, duke e lënë në hije këtë problem të madh të shoqërisë shqiptare. Kjo tregon edhe një herë se është ende i një rëndësie të veçantë ndërgjegjësimi i opinionit publik lidhur me integritimin e perspektivës gjinore dhe arritjen e barazisë

gjinore në Shqipëri. Përveç kësaj, bashkëbisedimet e fundit të qeverisë së re me përfaqësues të BE-së kanë patur gjithashtu në qendër të vëmendjes së tyre zhvillimin ekonomik dhe luftën kundër korrupsionit, duke lënë pas dore integrimin gjinor në politikëbërjen shqiptare.

4.9 Fuqizimi i grave në Shqipëri

Duke qenë se periudha e tranzicionit ka ndikuar negativisht në integrimin e gruas në tregun e punës, pjesëmarrja e gruas në vendimmarrje ka rënë në mënyrë të konsiderueshme dhe mbetet më e ulëta në krahasim me vendet e tjera të Europës Qendrore dhe Lindore. Të shumtë janë faktorët, ndër të cilët mund të përmenden zhvillimi i ngadaltë ekonomik dhe ri-strukturimi i burimeve, mentaliteti ekzistues i trashëguar, pritshmëritë e shoqërisë për gratë dhe shumë i rëndësishmi vullneti politik për të përfshirë gratë në vendimmarrje.

Karakteristikat e periudhës së tranzicionit në Shqipëri kanë ndikuar ndjeshëm në rënien e nivelit të pjesëmarrjes së grave në parlamentin shqiptar dhe në politikë. Vihet re menjëherë se përqindja e grave në parlamentin shqiptar në vitin 2002 ka qenë e krahasueshme me atë të vitit 1945, që tregon se periudha e tranzicionit ka ndikuar negativisht në statusin dhe rolin e grave në politikën shqiptare. Përfshirja e grave

në vendimmarrje mbetet një sfidë për shoqërinë shqiptare, pasi dhe përpjekjet e fundit nga partitë politike që synuan të arrijnë një përqindje 30% të pjesëmarrjes së grave si deputete nuk arritën rezultatin e dëshiruar. Vendi i grave në arenën politike, pra, mbetet shumë larg kërkesave dhe aspiratave të integritit të Shqipërisë në BE. “Këtë e treguan edhe njëherë zgjedhjet më të fundit parlamentare, ku gruaja mbeti përsëri në pakicë, madje në një numër të papërfillshëm për të shprehur vlerat e veta, si dhe për të dhënë kontributin e saj të domosdoshëm për ndryshimin e kërkuar. Ka arritur në 10 numri total i grave në parlamentin e tanishëm, pra vetëm 1 më tepër se në parlamentin e kaluar, shifër që mbetet ndër më të ulëtat e rajonit.”⁴¹

Nga përvojat e vendeve ku pjesëmarrja e gruas në politikë dhe vendimmarrje ka qenë e ulët vihet re se “një ndër rrugët për përmirësimin e kësaj gjendjeje, ndër të tjera, ka qenë përqendrimi tek brezi i ri i studentëve, veçanërisht i atyre që studiojnë për shkencat politike. Kërkohet një angazhim më i madh i tyre, veçanërisht në fushatat zgjedhore, si një përvojë e vyer politike për karrierën në të ardhmen si politikëbërës/e. Padyshim, ndryshimi i kësaj gjendjeje do të kërkonte një mbështetje më të madhe nga të gjithë faktorët ndikues, duke filluar nga familja, ndryshimi i mentalitetit shoqëror, mbështetja institucionale nga shteti e forcat politike, si dhe rritja ekonomike dhe përmirësimi i shërbimeve sociale që do

⁴¹ Cituar nga Marjeta Zaçe, Kryetare e Lidhjes Demokratike të Gruas së Shqipërisë “Koha për Rritjen e Pjesëmarrjes së Gruas në Vendimmarrje”, 2005.

të lehtësonin gratë për një angazhim më serioz dhe efikas të tyre në politikë.”⁴²

4.10 Debati mbi kuotat

Theksohet nga studiues të shkencave politike, sikurse dhe politikanë se, demokracia që të jetë funksionale, gjithëpërfshirëse dhe e legjitimizuar pikësëpari duhet të jetë e mbështetur nga baza shoqërore dhe jo të diktohet nga maja e piramidës së pushtetit. Në vendet ish-komuniste si Shqipëria, ku koncepti i demokracisë është ende i pa stabilizuar mirë, demokracia perceptohet të jetë njëfarë tregu i lirë ku fiton më i forti (zakonisht grupe elitash ekonomike) dhe konstatohet se pjesëmarrja e grupeve të ndryshme të shoqërisë dhe veçanërisht grave shihen si të fundit në listën e prioritetëve.

Organizimi demokratik i një shteti nënkupton se të gjitha grupeve u ofrohen mundësi të barabarta për të konkurruar në procesin e politikëbërjes. Por nëse mundësitë për arsim, punësim, shërbime shëndetësore, etj, favorizojnë më shumë njëren gjini sesa tjetrën, atëherë duhet të konsiderohet si i domosdoshëm përdorimi i mekanizmave të *përkohshëm* ekuilibruar si në rastin e kuotave. Themi të përkohshëm pasi kuotat duhet të përdoren derisa grave dhe burrave t’u ofrohen mundësi të barabarta në konkurrencën politike.

42 Po aty.

Ashtu siç u përmend më lart, në zgjedhjet parlamentare të vitit 2005 u synua që të arrihej një kuotë prej 30% për gratë deputete. *A janë kuotat metoda më e mirë për të përfshirë gratë në politikë?* Një debat i tillë mund të vërehet në shumë vende të botës, për më tepër në ato në zhvillim e sipër. Megjithatë, mundësia e prezencës së grave në nivelet e larta politike nuk do të thotë që ato do të angazhohen në çështjen e barazisë gjinore. Në fakt, shumë nga gratë e Europës Qendrore dhe Lindore hezitojnë të marrin përsipër çështjet e përkatësisë gjinore, pasi shpesh gjatë zgjedhjeve programi i të drejtave të grave dhe barazisë gjinore shihet si një faktor i rrezikshëm në uljen e shanseve për fitim. Platforma e grave në politikë, dhe pse vlerësohet si diçka e rëndësishme, nuk shihet si diçka që duhet nxitur për momentin.

Fakti mbetet që dhe kur shtypi fillon të hapë debate mbi rolin e kuotave në politikë, dhe vetë gratë janë të frikësuara, si pasojë e argumenteve kontradiktore që lidhen me rolin biologjik dhe shoqëror të grave. Këto role përshkruhen si të ndryshëm nga ato të burrave dhe këto argumente vijnë nga gazetarët burra. Një shembull i tillë është gazetari sllovak Schutz, i cili në një artikull shkruante se “manovrimi social (në këtë rast flitet për kuotat) është një formë moderne e komunizmit”.⁴³ Në shumicën e debateve publike, politikanë burra dhe gra që kundërshtojnë sistemin e kuotave shprehen se ato gra që duan të arrijnë suksesin politik e bëjnë këtë dhe pa ndihmën

e kuotave. Vihet re se sistemi i kuotave është diçka që duhet mbështetur nga baza e piramidës, d.m.th. nga vetë njerëzit e thjeshtë, në mënyrë që të funksionojë. Çdo ligj i pabazuar në një miratim të njerëzve të thjeshtë, në këtë rast të grave, është i pavlefshëm pasi nuk do të ketë mundësi të zbatohet në mungesë të trysnisë që mund të ushtrohet nga ato vetë për të arritur të drejtat e tyre. Në rastin e Shqipërisë, si dhe të shumë vendeve në zhvillim, vendosja e një ligji nga maja e piramidës nuk është i mjaftueshëm për t'u dhënë grave dhe burrave të drejta të barabarta.

Kuotat përpiqen të përfshijnë më shumë gra në politikë dhe nivele vendimmarrëse pasi gratë përfaqësojnë më mirë interesat e vetë grave. Nga eksperiencia e vendeve të zhvilluara është konstatuar se gratë sjellin në diskutim probleme të mprehta sociale siç është punësimi, arsimit, shërbimet shëndetësore për fëmijët, etj.

Shumë studiues dhe politikanë nuk bien dakord në zbatimin e kuotave pasi pretendohet se nuk janë mjete “demokratike” dhe i hapin rrugë debatit mbi cilësinë e grave që përfshihen në politikë me anë të tyre. Pikësëpari, a është demokratike një shoqëri ku si në rastin e Shqipërisë ka vetëm 7.1% të grave në parlament ndërkohë që ato përfaqësojnë 50.2% të popullatës? Dhe së dyti, pse nuk debatohet në të njëjtin nivel për cilësinë e burrave politikanë përkundrejt grave?⁴⁴

44 Blerta Picari & Sonila Danaj, *Pse kuotat mbeten ende një zgjidhje*, GAIA nr 3, Aleanca Gjinore për Zhvillim, 2007,

Zbatimi i sistemit të kuotave shpesh ndeshet me sjellje negative në vendet në zhvillim ku ky lloj sistemi bën lindjen e imazhit të grave ‘*proxy*’.⁴⁵ Dhe në rastin kur gratë arrijnë të zgjidhen në pushtetin lokal (një gjë që ndodh më shpesh se në atë qendror), shpesh janë burrat e tyre, familjarët apo pjesëtarët burra të pushtetit lokal ata që marrin vendimet në vend të tyre. Por, ndryshime vihen re pasi vendet e rezervuara në pushtetin lokal dhe në parlament kanë bërë që programi i grave për edukim, shëndet dhe papunësi të grave të diskutohen gjithnjë e më shumë. Disa nga gratë që kishin marrë pjesë aktivisht në vendimet e pushteti lokal kishin zgjidhur plot probleme të komunitetin në të cilin jetonin. Pra, pa u shkurajuar, mund të arrihet në përfundimin se sistemi i kuotave është dhe duhet të jetë një masë e përkohshme që garanton ligjërisht dhe moralisht të drejtën e pjesëmarrjes së grave në politikë. Qëllimet dhe arritja e kuotave varen dhe nga vetë sjellja dhe këmbëngulja që kanë gratë për të arritur aty ku synojnë.

Kuotat për vendet në zhvillim mbeten një hap i parë në përfaqësimin e grave dhe vajzave, por si politikë më vete, duhet të jenë të shoqëruara nga iniciativa të tjera si ato të mundësive për trajnim dhe arsimim jo vetëm fillor dhe të mesëm, por edhe të lartë dhe pas-universitar, si dhe një ri-organizim të rolit së gruas në familje dhe përgjegjësitë e saj

45 Termi *proksi* është përdorur në këtë rast duke iu referuar stereotipit Indian se gratë në vendimmarrje, qoftë dhe në atë lokale janë thjesht “kukulla” në duart e burrave të tyre, politikanëve apo familjarëve.

në komunitet. Paraqitja e kuotave të kandidimit si një zgjidhje e përkohshme, n.q.s. mbetet e vetme si strategji për përfshirjen e grave në politikë, është e destinuar të dështojë, pasi fuqizimi i grave nuk vjen vetëm nga marrja pjesë si e ftuar në procesin vendimmarrës por ka të bëjë me të qenit e aftë dhe fuqiplotë në marrjen e vendimeve.⁴⁶ Stefanie Strulik, e cila merret me rolin e grave Indiane në politikë, shkruan se mënyra më e mirë për të kapërcyer pengesat nuk është ajo që i bën gratë të përshtaten me ambientin politik, por është shndërrimi i sistemit politik në një sistem më miqësor, të tillë ku gratë të jenë të mirëpritura.⁴⁷ Në mënyrë që të arrihet ky synim, duhet një punë e gjatë në zbatimin e legjislaturës së vendit tonë dhe një angazhim i thellë i mekanizmave kombëtare dhe OJQ-ve për një konsolidim të platformës për veprim të barazisë gjinore.

Të gjithë e dimë se ndryshimi i mentalitetit, reformimi i institucioneve të arsimit dhe rritja ekonomike nuk ndodh brenda natës por kërkon një periudhë shumë të gjatë kohe. Deri atëherë... a do të shohim më shumë se dhjetë gra politikanë në parlament nëse nuk vendosim kuota përfaqësimi për to?

46 Caroline Szyber (duke cituar Rowlands 1997) 'Capacities Building Strategies Towards Women Going into Politics' thesis based on field study, India 2005.

47 Strulik Stefanie 'Deconstructing Proxy women in a Decade of Women's Empowerment through Local Government in India' workshop report October 20-21 2003, New Delhi Institute of Social Science.

4.11 Zvogëlimi i vdekshmërisë foshnjore dhe përmirësimi i shëndetit të nënës

Mungesa e fondeve për të përmirësuar shërbimet ndaj shëndetit të nënës dhe fëmijës, si dhe strukturat e politikave sociale nuk ekzistojnë apo funksionojnë me efikasitet në vendin tonë dhe kjo është një rrjedhojë që vjen dhe nga ri-strukturimi i burimeve dhe reformat ekonomike. Mangësitë që ndeshen si rrjedhojë e mungesës së edukimit vihen re tek mungesa e kujdesit që gratë tregojnë për veten apo fëmijët e tyre. Barazia ndaj aksesit të shërbimeve shëndetësore të burrave dhe grave duhet të jetë një prioritet në Shqipëri, përveç përmirësimit të shërbimeve shëndetësore dhe shpërndarjes së informacionit.

4.12 Shëndeti i nënave dhe fëmijëve në Shqipëri

Duke u bazuar në Raportin e Zhvillimit Njerëzor të vitit 2005, Shqipëria ka hartuar një sërë planesh, të cilat janë përqendruar në mirëqenien shëndetësore të nënës dhe fëmijës. Ndër këto mund të përmendet Konferenca e Kajros për Zhvillimin Ndërkombëtar të Popullsisë (1994), e cila e vendos gruan në qendër të shërbimeve shëndetësore riprodhuese me kujdesin shëndetësor parësor. Edhe pse në dekadën e fundit vdekja amësore në Shqipëri ka qenë më e ulët (në vitin 2000 ishte 50% më e ulët se në vitin 1990), kur krahasohet me vendet e tjera të Europës ajo mbetet sërish e lartë.

Për shkak të mungesës së statistikave është vështirë të shpjegohen faktorët kryesorë që ndikojnë në një dukuri të tillë. Megjithatë, vihen re ndryshime rajonale të cilët tregojnë se vdekshmëria amësore ndikohet drejtpërdrejt nga faktorë ekonomikë, socialë, kulturorë dhe psikologjikë. Në rajonet më të varfra të vendit (Tropojë, Has dhe Kukës) vdekshmëria amësore është më e lartë. Mundësia për të pasur shërbim shëndetësor në afërsitë banimit, disponueshmëria dhe cilësia e shërbimit mbeten çështje kyçe për gratë dhe vajzat e zonave të thella rurale.

Një faktor tjetër që ndikon në mirëqenien shëndetësore të grave dhe vajzave mbetet aborti, i cili ka pësuar rritje këto vitet e fundit, duke tërhequr vëmendjen për nevojën e programeve dhe politikave më të mira për planifikimin familjar. Faktorët që ndikojnë në numrin e lartë të aborteve janë të shumtë, ku veçanërisht mund të përmendet varfëria, papunësia, numri i lartë i fëmijëve në familje, shëndeti i varfër, por edhe gjinia e fëmijës, e cila ndikon drejtpërdrejt në shtimin e aborteve kur fëmija është vajzë. Kjo e fundit ndikohet nga mentaliteti shqiptar, ku djali shihet si siguruesi i të ardhmes ekonomike dhe trashëgimtari i emrit të familjes.

Statusi i grave në shoqëri ka lidhje të drejtpërdrejtë me politikat institucionale që lehtësojnë rolin e grave në familje, sidomos kur flitet për lejen e lindjes. Në Shqipëri leja e lindjes është 365 ditë dhe pagesa ndryshon nga 50-80% e pagës. Kjo procedurë zakonisht zbatohet në institucionet shtetërore por praktikohet shumë rrallë në sektorin privat.

4.13 Lufta ndaj HIV/SIDA, malaries dhe sëmundjeve të tjera

Ndalimi dhe ulja e sëmundjeve vdekjeprurëse dhe seksualisht të transmetueshme është efi kase kur luftohet në bashkëpunim me disa fusha të tjera të barazisë gjinore siç është injoranca seksuale, e cila mund të jetë rrjedhojë e mentalitetit apo mosedukimit si dhe pamundësisë së aksesit në informacion. Ky i fundit mund të luajë një rol kyç në planifikimin familjar dhe alternativat që u ofrohen grave të dhunuara seksualisht. Në këtë rast, barazia gjinore në marrëdhëniet familjare, martesë, shërbimet shëndetësore etj, si dhe fuqizimi i grave janë të domosdoshme për përmirësimin e situatës.

4.14 Përmirësimi i mjedisit përreth

Shumë nga gratë, sidomos ato në zonat rurale, janë të ngarkuara me punën bujqësore dhe shërbimet themelore të familjeve të tyre siç janë uji, ushqimi dhe mirëqenia. Mungesa e aksesit ndaj burimeve natyrale dhe degradimi i ambientit kanë një efekt negativ, pasi ndotja dhe privatizimi i shërbimeve që dikur ishin publike ka bërë që të shtohet ngarkesa e grave. Shumica e vajzave të familjeve ndihen të detyruara në këtë mënyrë të ndihmojnë nënat e tyre dhe këtu fillon braktisja e shkollës dhe keqësimi i shëndetit. Në vendit tonë degradimi i ambientit dhe ndikimi i tij mbi popullatën mund të vihet re në shumë zona me mbetje kimike si ajo e Porto Romanos në

Durrës, ku sëmudjet kronike janë më të shumta se në pjesët e tjera të vendit. Në këtë kontekst, për përmirësimin e kushteve të grave duhet zgjidhur shpejt ligji i pronësisë dhe garantimi i pjesëmarrjes së grave në qeverinë lokale, sidomos në vendet rurale, për të reflektuar dhe përmirësuar ligjet ekzistuese, të cilat ndikojnë në rritjen e aksesit dhe kontrollit që kanë gratë dhe vajzat, duke nxitur në këtë mënyrë zhvillimin ekonomik dhe social të një rajoni.

4.15 Zhvillimi i një plani botëror bashkëpjesëmarrës

Arritja e qëllimeve të mijëvjeçarit mbetet një strategji delikate n.q.s. nuk mbështetet nga organizatat ndërkombëtare, qeveritë e shteteve të ndryshme, institucionet financiare dhe tregtare botërore. Të drejtat e grave dhe fuqizimi i tyre janë dy pika kyçe për të arritur vendimet dhe synimet e drejta për të gjithë pjesëtarët e shoqërisë. Konventa CEDAW dhe PVP nënvizojnë rëndësinë dhe masat që duhen marrë për të garantuar që gratë dhe perspektiva e tyre të luajë një rol qendror në vendimmarrje në të gjitha nivelet e veprimtarive njerëzore.

5. Përfundime

5.1 Aty ku ka Vullnet, ka dhe rrugëzgjdhje

Negociatat e vazhdueshme të qeverisë shqiptare me përfaqësuesit e BE-së na rikujtojnë vazhdimisht dëshirën për të qenë së shpejti pjesë e këtij komuniteti dhe fillimin e reformimit të gjendjes aktuale në vendin tonë. Megjithatë, çështja e barazisë gjinore, si pjesë e reformimit ekonomik-strukturor-politik përmendet rrallë nga politikë-bërësit shqiptarë, duke e lënë vendin tonë përsëri një hap prapa standardeve të BE-së. Anëtarësimi në BE shihet si udhërrëfyes, një farë ylli polar, por rrugës dhe mënyrës për të arritur deri atje nuk i jepet shumë rëndësi. Shumë njerëz mendojnë se integrimi në BE do të zgjidhte shumë nga problemet tona, kur në fakt duhet të mendohet në mënyrë të anasjelltë: vetëm zgjidhja e problemeve tona do të mund të hapë dyert drejt integritit në BE.

Zhvillimi dhe ri-strukturimi ekonomik në Shqipëri është absolutisht i nevojshëm, por nuk duhet të bëhet në kurriz të sektorëve të populluar nga gratë dhe vajzat. Lufta kundër

korrupsionit dhe forcimi i shtetit ligjor janë gjithashtu prioritete, në përmbushjen e të cilave duhet të marrin pjesë dhe gratë të cilave u duhen dhënë mundësitë për të kapërcyer sferën e familjes dhe të rishikojnë përgjegjësitë ndaj komunitetit si pjesëtare të barabarta të shoqërisë. Kushti themelor për ndryshimin e situatës në Shqipëri për të arritur standardet Europiane është **angazhimi dhe përkushtimi i grave dhe vajzave për të arritur barazinë gjinore**, pasi ato mbeten aktoret kryesore për realizimin e objektivave të tyre.

Fjalorth termash

Aksesi: i referohet mundësive të grave dhe burrave për të siguruar apo përdorur burimet (ushqime, kredi, teknologji, etj.) ose shërbimet (arsim, shërbim shëndetësor, etj.). Mundësia për të përfituar mbi burimet nuk nënkupton patjetër se njerëzit do të kenë pushtet për të vendosur apo për të kontrolluar të mirat që rrjedhin prej aktiviteteve të tilla. (Overholt, C., Anderson, M., Cloud, K. dhe Austin, J.,: 1985).

Është e rëndësishme të dallohet ndryshimi mes “*përdorimi i*” dhe “*kontroll mbi*” një burim të caktuar. Për shembull, gratë në zonat rurale shpesh kanë akses mbi tokën apo kredinë, por ato nuk kanë pushtet dhe mundësi për të marrë vendime mbi këto burime. (Moser, C.:1989).

Shembull: World Food Programme (WFP) ka marrë përsipër të përmirësojë aksesin e grave mbi asetet (njësi me vlerë që i përket një individi, familjeje apo grupi individësh (WFP, 1995 dhe FAO, 1990).

Barazia gjinore: ky është një parim, sipas të cilit të gjitha qeniet njerëzore, pa dallim race, seksi, bindjeje fetare, niveli social-kulturor apo status politik, duhet të kenë të drejta ligjore

të barabarta. Në kontekstin e të drejtave ndërkombëtare të njeriut, koncepti ligjor i barazisë gjinore është sanksionuar si në Deklaratën Universale për të Drejtat e Njeriut të vitit 1948 ashtu edhe në Konventën e Kombeve të Bashkuara mbi Eliminimin e të Gjitha Formave të Diskriminimit Kundër Grave (CEDAW) të vitit 1979. Konventa, e cila është ratifikuar nga 100 vende, deklaron qartë dhe pa ekuivokë që “diskriminimi kundër grave dhunon parimet e barazisë së të drejtave dhe respektit për dinjitetin njerëzor.” Qeveritë e botës riafirmuan angazhimin e tyre në vitin 1995 për “të drejtat e barabarta dhe dinjitetin e lindur njerëzor të të gjithë grave e burrave”, në Deklaratën e Platformës së Pekinit për Veprim.

Diskriminimi: është një sjellje e dukshme me anë të së cilës njerëzit trajtohen ndryshe dhe jo në mënyrë të favorshme, në bazë të racës, klasës, seksit apo statusit kulturor të tyre. Diskriminimi pakëson mundësitë për të pasur akses mbi burimet, shërbimet shëndetësore, arsimimin, fuqizimin apo pushtetin. Në terminologjinë e Konventës së Kombeve të Bashkuara për Eliminimin e të Gjitha Formave të Diskriminimit ndaj Gruas (CEDAW), konsiderohet si përjashtim, pengesë apo dallim i bërë në bazë të seksit, që ka si qëllim apo efekt mohimin e ushtrimit të barabartë të të drejtave dhe lirive themelore të njeriut në të gjitha fushat e përpjekjeve njerëzore.

Fuqizimi: është një proces përmes të cilit burrat dhe gratë që ndodhen në pozita të pa favorshme rritin aksesin e tyre ndaj informacionit, burimeve e pushtetit vendim-marrës

si dhe ndërgjegjësimin e tyre lidhur me pjesëmarrjen në jetën komunitare, me qëllim që të arrijnë një nivel të caktuar kontrolli mbi mjedisin ku jetojnë.

Shembull: Në Indi, një lëvizje e madhe me qëllim fuqizimin e gruas dhe si një masë kundër varfërisë, Amendamentet 73 dhe 74 të Kushtetutës (Panchayat Raj Act) të vitit 1993 siguruan një minimum prej 1/3 e vendeve për gratë në të gjitha postet shtetërore, përkatësisht 250,000 gra të punësuara në nivel lokal.

Drejtësia gjinore: Drejtësia gjinore merret me promovimin e barazisë personale, shoqërore, kulturore, politike dhe ekonomike për të gjithë. Termi drejtësi gjinore lindi nga të kuptuarit gjithnjë e më shumë të padrejtësive të kudogjendura në shoqëri. Traditat e vazhdueshme të koncepteve stereotipa dhe praktikave diskriminuese kanë rezultuar në zhvlerësimin sistematik të qëndrimeve, veprimtarive dhe aftësive që i atribuohen vajzave dhe grave. Pasojat negative të koncepteve stereotipa dhe praktikave diskriminuese ndikojnë pafavorshëm si meshkujt ashtu edhe femrat. Megjithatë, nga pikëpamja afatshkurtër, theks më i madh në nismat për drejtësinë gjinore do të vendoset mbi përmirësimin e kushteve dhe qëndrimeve që prekin vajzat dhe gratë. Nga pikëpamja afatgjatë, këto nisma do të përmirësojnë gjithashtu edhe situatën për djemtë e burrat.

Barazia gjinore përkundrejt drejtësisë gjinore: Dhe pse termat barazi dhe drejtësi gjinore janë përdorur shpesh në vend të njëri-tjetrit, ata tashmë kanë kuptime specifike dhe të ndryshme dhe nuk duhen ngatërruar. Barazia gjinore i referohet trajtimit të njëjtë apo njëhsimi në sasinë, vlerën dhe intensitetin e masave të marra dhe të zbatuara për burrat dhe gratë. Barazia gjinore mund të shprehet lehtë përmes legjislacionit. Ndërkohë drejtësia gjinore nënkupton që të bëhet çfarë është e nevojshme për të siguruar barazi rezultatesh në eksperiencat e jetës të burrave dhe grave. Drejtësia gjinore është e vështirë të shprehet përmes legjislacionit: trajtimi identik mund të kënaqë kriterin e barazisë, por jo atë të drejtësisë.

Barazia e rezultatit, që ndryshe quhet “barazia thelbësore” i mëshon idesë që barazia në shanse mund të mos jetë e mjaftueshme për të riparuar shtypjen dhe disavantazhin historik të grave. Për shkak të pozicioneve të ndryshme në shoqëri, gratë e burrat mund të mos jenë të aftë të shfrytëzojnë shanse të barabarta në të njëjtën masë. Në disa raste, shanset e barabarta mund të kenë në fakt një ndikim negativ mbi mirëqenien e grave, nëse gratë ushtrojnë kohë dhe energji për t’i shfrytëzuar ato pa ndonjë rezultat. Me qëllim që të sigurohet që ndërhyrjet e zhvillimit të rezultojnë në barazi të rezultatit për gratë dhe burrat, është e nevojshme që ato të ndërtohen mbi bazën e analizës gjinore. Për pasojë, trajtim “i barabartë” nuk do të thotë trajtim “i njëjtë.”

Barazia gjinore si objekt zhvillimi: “Në Konferencën e Katërt Botërore të Kombeve të Bashkuara për Gratë mbajtur në Pekin në vitin 1995, vendet partnere morën angazhime për barazinë gjinore dhe fuqizimin e grave. Deklarata e Pekinit e miratuar në Konferencë, ndërtohet mbi perspektivat dhe strategjitë e përvijuara në konferencat e mëparshme të Kombeve të Bashkuara mbi arsimin – Jomtien, (1990), mjedisin – Rio (1992), të drejtat e njeriut – Vjenë (1993), popullsinë – Kairo (1994), dhe zhvillimin shoqëror – Kopenhagen (1995), përfshi edhe Konventën për Eliminimin e të Gjitha Formave të Diskriminimit kundër Grave (CEDAW 1979). Ajo bazohet mbi parimet e të drejtave të njeriut dhe drejtësisë shoqërore. Barazia gjinore dhe fuqizimi i grave janë të domosdoshme për trajtimin e problemit të varfërisë dhe pasigurisë, si dhe për arritjen e zhvillimit të qëndrueshëm, duke pasur në qendër të vëmendjes njerëzit.”

Integrimi Gjinor: është (ri) organizimi, përmirësimi, zhvillimi dhe vlerësimi i proceseve politike, në mënyrë që perspektiva gjinore të trupëzohet në të gjitha politikatat, nivelet dhe fazat nga aktorët që përfshihen normalisht në hartimin e politikave. Është një strategji për t'i ngritur shqetësimet e grave dhe të burrave dhe eksperiencat e tyre në një dimension integral në hartimin, zbatimin, monitorimit dhe vlerësimin e politikave dhe programeve në sferën politike, ekonomike, sociale etj.

Kontrolli: i referohet kapacitetit për të marrë vendime mbi një burim apo situatë të caktuar. Është e rëndësishme të

dallohet ndryshimi mes aksesit dhe kontrollit mbi *përdorimin* e burimeve, nga njëra anë, dhe aksesit e kontrollit mbi *përfitimet* që rrjedhin nga përdorimi i burimeve nga ana tjetër. Edhe në rast se gratë kanë burime të pafundme, ato shpesh nuk kanë mundësi të përfitojnë nga përdorimi i tyre. (Overholt, C., Anderson, M., Cloud, K. dhe Austin, J.,: 1985). Të dhënat bazë në një analizë të plotë gjinore përcaktojnë nëse ka ndonjë ndryshim në aksesin dhe kontrollin e burave dhe grave ndaj tri kategorish kyçe të burimeve:

1. Burimet Ekonomike/Prodhuese: toka, kredia, të ardhurat në para, punësimi
2. Burimet Politike: arsim, përfaqësim politik, udhëheqje
3. Koha: një burim kritik, i cili përfton gjithnjë e më shumë vlerë monetare

Është e qartë pra që të kesh akses apo të kesh kontroll mbi një burim nuk janë e njëjta gjë.

Kushtet e Grave: janë gjendja e tyre materiale nga pikëpamja e nivelit të ushqimit, shëndetit, aksesit ndaj nevojave bazë, arsimit, dhe këto mund të përmirësohen duke ofruar ushqim, shërbime shëndetësore, arsim, etj.

Kuota: është një sistem që në politikë garanton pjesëmarrjen e grave apo grupeve të nënpërfaqësuar shoqërore nëpërmjet rezervimit të vendeve në qeverisjen e pushtetit lokal dhe parlamentar. Kuotat përdoren shpesh dhe në arsim për të

garantuar dhe promovuar vendet që u përkasin në mënyrë të barabartë të gjithë individëve në shoqëri.

Nevojat Gjinore: dallojnë nga nevojat në përgjithësi për shkak se ato dalin nga rolet gjinore, ndarja gjinore e punës dhe nga ndërlikimet e vazhdueshme që vijnë prej mungesës së aksesit ndaj burimeve dhe nga marrëdhëniet e pabarabarta të pushtetit. Për shkak se kanë role të ndryshme në shoqëri, gratë dhe burrat kanë dhe nevoja të ndryshme. Është mjaft e nevojshme dhe e rëndësishme të dallojmë dy lloje nevojash; nevojat gjinore praktike dhe interesat gjinorë strategjikë.

Rolet Gjinore: Përfshijnë rolin prodhues, riprodhues dhe komunitar.

Roli Prodhues: ka të bëjë me punën që kryhet për të prodhuar mallra e shërbime në shkëmbim të të ardhurave. Edhe burrat edhe gratë kontribuojnë në të ardhurat e familjes me forma të ndryshme pune prodhuese, ndonëse burrat mbizotërojnë në punën prodhuese, sidomos në shkallët më të larta të shpërblimit.

Roli Riprodhues: përfshin riprodhim biologjik dhe social. *Riprodhimi biologjik* i referohet lindjes së qenieve të reja njerëzore, një aktivitet të cilin vetëm gratë mund ta kryejnë. *Riprodhimi social* i referohet gjithë aktiviteteve të përkujdesjes së nevojshme për të siguruar mbijetesën dhe vazhdimësinë njerëzore. Kujdesi për fëmijët, gatimi, ushqimi, larja, pastrimi,

ushqimi me gji dhe aktivitete të tjera shtëpiake futen në këtë kategori. Megjithëse ato janë të nevojshme për mbijetesën njerëzore, nuk konsiderohen as punë, as aktivitete ekonomike, dhe si të tilla janë të padukshme, të panjohura dhe të papaguara. Puna riprodhuese kryhet kryesisht nga gratë dhe vajzat.

Roli Komunitar: i referohet të gjithë atyre aktiviteteve të nevojshme për të menaxhuar dhe organizuar jetën komunitare. Qeverisja, organizimi dhe pjesëmarrja në festivale kulturore dhe shoqërore, shërbimet shoqërore dhe shërbimet si: rrugët, shkollat, shërbimi shëndetësor, etj., janë të gjitha aktivitete komunitare. Si burrat, ashtu dhe gratë marrin pjesë në to, por përsëri sipas normave të caktuara, që përcaktojnë aktivitetet ‘mashkullore’ dhe ‘femërore’.

Pozita e Grave: është vendi apo statusi i tyre në shoqëri në lidhje me burrat. Për të vlerësuar pozitën, nevojitet të shohim marrëdhëniet shoqërore të gjinisë apo marrëdhëniet e pushtetit mes grave dhe burrave.

Zëvendësimi/Proxy: është një term i përdorur nga disa njerëz të cilët mendojnë se gratë e zgjedhura në pushtetin lokal (në Indi dhe vende të tjera në zhvillim) janë vetëm kukulla në duart e burrave, familjeve apo pjesëtarëve burra të pushtetit lokal.

The background features a collection of stylized icons. On the left side, there are five stars of varying sizes, each filled with a black and white zigzag pattern. On the right side, there are five human figures of varying sizes, also filled with the same zigzag pattern. The figures include a tall male figure, a shorter female figure, and two smaller figures at the bottom.

SHTOJCË

**Dokumente
ndërkombëtare të
nënshkuara nga Qeveria
Shqiptare**

CEDAW– Konventa e Kombeve të Bashkuara mbi Eliminimin e të gjitha Formave e Diskriminimit ndaj Grave– (Convention for the Elimination of all forms of Discrimination Against Women) është miratuar në vitin 1979 nga Asambleja e Përgjithshme e Kombeve të Bashkuara dhe shpesh përshkruhet si një ligj ndërkombëtar për të drejtat e grave. Kjo Konventë përbëhet nga një parathënie prej 30 nenesh dhe përcakton se çfarë përbën diskriminim ndaj grave, duke vendosur një program për veprime kombëtare për t'i dhënë fund diskriminimit.

Kjo Konventë e përcakton diskriminimin ndaj grave si “...çdo dallim, përjashtim apo frenim i bërë në bazë të seksit, i cili ka efekt apo synim të dëmtojë apo të shfuqizojë njohjen, gëzimin apo ushtrimin e të drejtave themelore politike, ekonomike, sociale, kulturore, civile, etj., nga ana e grave, pavarësisht nga statusit të tyre civil, bazuar në parimin e barazisë mes grave dhe burrave.”⁴⁸

Deklarata e Pekinit dhe Platforma për Veprim (PVP)- The Beijing Declaration and Platform for Action: është miratuar në Konferencën e Katërt mbi Gratë: Veprim për Barazi, Zhvillim dhe Paqe, e mbajtur në Pekin datë 15 Shtator 1995. Platforma për Veprim është një program që adreson fuqizimin e grave. Ajo synon përshpejtimin dhe zbatimin e Strategjive të Nairobit për përparimin e grave, si dhe eliminimin e pengesave të pjesëmarrjes aktive të grave në të gjitha sferat

⁴⁸ Burimi: <http://www.un.org/womenwatch/daw/cedaw/cedaw.htm> (Parë për herë të fundit: 11 dhjetor 2005).

e jetës publike dhe private përmes proceseve të përbashkëta vendimmarrëse në fushat ekonomike, sociale, kulturore dhe politike.⁴⁹ Konventa është ratifikuar në vitin 1993 nga qeveria shqiptare.

Objektivat e Zhvillimit të Mijëvjeçarit (OZHM) - Millenium Development Goals (MDGs). Në shtator të vitit 2000, udhëheqësit e 191 vendeve të botës nënshkruan Deklaratën e Mijëvjeçarit, e cila, duke sintetizuar konventat dhe deklaratat e mëparshme mbi zhvillimin, përcakton 8 Objektivat e Zhvillimit të Mijëvjeçarit. Nëpërmjet këtyre objektivave, çështje të tilla si: zhdukja e varfërisë, kryerja universale e arsimit bazë, nxitja e barazisë gjinore dhe fuqizimi i rolit të gruas, zvogëlimi i vdekshmërisë foshnjore, rritja e kujdesit për shëndetin e nënës, lufta kundër sëmundjeve të rrezikshme, sigurimi i një mjedisi të qëndrueshëm dhe partneriteti për zhvillim global, u vlerësuan si kërkesat më themelore për të nxitur një zhvillim të qëndrueshëm të secilit vend. Si një nga shtetet që ka firmosur këtë deklaratë, Shqipëria, e mbështetur nga PNUD, është përfshirë në një proces të gjerë njohjeje, ndërgjegjësimi, zërthimi e zbatimi të secilit prej Objektivave të Mijëvjeçarit, brenda vitit 2015.⁵⁰

49 Platforma për Veprim e Pekinit. Për më tepër informacion, vizitoni: <http://www1.umn.edu/humanrts/instree/e5dplw.htm#one> (Parë për herë të fundit: 9 dhjetor 2005).

50 UNDP dhe Qendra për Nxitjen e Zhvillimit Njerëzor. Nxitja e zhvillimit rajonal nëpërmjet Objektivave të Mijëvjeçarit. Tiranë: PEGI, faqe 7.

Bibliografia

Advisory Committee on Equal Opportunities for Women and Men,
Opinion on Men in Gender Equality, 2006.

Advisory Committee on Equal Opportunities for Women and Men,
Opinion on Gender Pay Gap, March 2007.

Advisory Committee on Equal Opportunities for Women and Men,
The role of civil society in implementing European legislation on equal treatment for women and men in the area of equality at work, October 2006.

Aleanca Gjinore për Zhvillim, *Drejt Rrugës për në BE- Monitorim i Shanseve të Barabarta për Gratë dhe Burrat në Shqipëri*, Pëgj, 2006.

Bushati, D. *EU Integration Process-Means to Advance, Aleanca Gjinore për Zhvillim Shkolla Verore*, korrik 2007.

Commission of the European Communities, *Report from the commission to the council, the European parliament, the European economic and social committee and the committee of the regions on equality between women and men*, 2007.

Commission of the European Communities, *Communication from the Commission to the Council, the European Parliament, the*

European Economic and Social Committee and the Committee of the Regions – A Roadmap for equality between women and men 2006-2010, March 2006.

Council Resolution of 15 December 1997 on the 1998 Employment Guidelines (98/C 30/01), OJ No. C 030, 28.1.98.

COM (1999) 106 final, Bruksel 5 Mars 1999, *1998 Annual report from the Commission on Equal Opportunities for Women and Men in the European Union.*

COM (2000) 335 final of 07.06.2000.

COM (1999) 106 final, Brussels, 05.03.1999.

Diamantopoulou, Ana. *Kuadri i ardhshëm strategjik mbi barazinë gjinore.* Gender Equality Magazine, No. 9.

Equal Opportunities for Women and Men: *Monitoring law and practice in new member states and accession countries of the European Union*, Open Society Institute Network Women's Program, 2005.

European Women' Lobby 'Beijing + 10 1995-2005, Review of the Implementation of the Beijing Platform for Action by the European Union', nëntor 2004.

Gruaja në Zhvillim. *Raport rajonal mbi mekanizmat institucionalë për avancimin e gruas në vendet e Europës Qëndrore dhe Lindore.* Komisioni Karat për veprimtarite rajonale. Varshavë, shkurt, 1999.

Gjykata Europiane e Drejtësisë, http://curia.europa.eu/en/instit/presentationfr/index_cje.htm (parë për herë të fundit më 10 shkurt 2008).

Hautala, H. & Përfaqësuesit e Komisionit 8.10.1998 në Bled, Slovenia, cituar në: *1998 Report of the Commission on Equal Opportunities for Women and Men in the European Union.*

Instituti i Studimeve Ndërkombëtare. *Integrimi Europian, Përfytyrime dhe Realitete.* Tiranë 2004.

Interim report of the Commission to the European Parliament, the Council, the Economic and Social Committee and the Committee of the Regions on the implementation of the medium-term *Community Action Programme on equal opportunities for women ad men* (1996 to 2000) – European Commission, Directorate-General for Employment, Industrial Relations and Social Affairs, 1999.

Këshilli i Ministrave. *Programi i Nxitjes së Punësimit të Punëkërkesve të Papunë Femra.* dhjetor 2003.

National Forum of Europe, *Making the European Union Relevant for Women*, Stationery Office: Dublin. 2007.

Picari, B. & Danaj, S. *Pse Kuotat mbeten ende një zgjidhje*, GAIA nr. 3, Aleanca Gjinore për Zhvillim, 2007.

Raporti i Parë Kombëtar CEDAW, 2002.

Strulik, Stefanie. *Deconstructing Proxy women in a Decade of Women's Empowerment through Local Government in India.* Raport i seminarit të mbajtur më 20-21 tetor 2003. New Delhi, Institute of Social Science.

Schutz, P. "Engineers of Human Happiness" SME 1.3.2004.

Szyber, Caroline. "Capacities Building Strategies Towards Women Going into Politics" thesis based on field study, India 2005.

Zaçe, Marjeta- Kryetare e Lidhjes Demokratike të Gruas së Shqipërisë “Koha për Rritjen e Pjesëmarrjes së Gruas në Vendimmarrje”, 2005.

UNDP & SEDA Politikat dhe Zhvillimi në Dobi të të Varfërve e të Grave në Shqipëri: Vënia në Veprim e Objektivave të Zhvillimit të Mijëvjeçarit”, Raporti i Zhvillimit Njerëzor për Shqipërinë 2005.

UNDP dhe Qendra për Nxitjen e Zhvillimit Njerëzor. Nxitja e zhvillimit rajonal nëpërmjet Objektivave të Mijëvjeçarit. Tiranë: PEGI (pa vit botimi).

The Enlarged European Union and Its Agenda for a Wider Europe: What Considerations for Gender Equality?” A report of a WIDE hearing held at the European Parliament. Bruksel, 2 dhjetor 2004.

The Economist. *Të menduarit e ri rreth një problemi të vjetër*. 17-23 shtator, 2005.

The European Commission Directorate General for Economic and Financial Affairs “*The Western Balkans in Transition*”, N. 23 – dhjetor 2004.

Waldorf, Lee “Pathway to Gender Equality: CEDAW, Beijing and the MDGs”, UNIFEM, GTZ and the German Federal Ministry for Economic Cooperation and Development, 2005.

Burime nga Interneti:

Gender and European Integration, Glas Razlike Për informacion të mëtejshëm refererohuni tek www.womenngo.org.yu/gazrazlike. (Parë për herë të fundit: 10 nëntor 2005).

Pakti i Stabilitetit, nga Ideja në Projekt, Ministria e Punëve të Jashtme <http://www.mfa.gov.al/shqip/pakti.asp> (Parë për herë të fundit në 10 nëntor 2005)

Parlamenti European. Për më shumë informacion, vizitoni <http://www.europarl.europa.eu/parliament/public.do?language=en> (Parë për herë të fundit në 10 shkurt 2008).

Platforma për Veprim e Pekinit. Për më tepër informacion, vizitoni: <http://www1.umn.edu/humanrts/instree/e5dplw.htm#one>. (Parë për herë të fundit në 9 dhjetor 2005).

Traktati që ka ngritur Komunitetin e Qymyrit dhe Çelikut (ECSC) http://europa.eu.int/ecsc/index_en.htm, (Parë për herë të fundit në 10 nëntor 2005)

Women's Political Representation Improvement, The Network of East-West Women-Polska/NEWW www.neww.org.pl/news

Zbatimi i Konventës CEDAW, <http://www.un.org/womenwatch/daw/cedaw/cedaw.htm> (Parë për herë të fundit në 11 dhjetor 2005).

